


Raporti i  
zbatimit të  
**Ligjit për ndalimin  
dhe mbrojtjen nga  
diskriminimi**  
2011 – 2018





**Autorët:**

Igor Jadrovski  
Jovana Jovanovska Kanurkova  
Marija Gelevska

**Përkthimi në gjuhën shqipe:**

Ana Dimovska

**Redaktimi grafik:**

Studio Igor Delov

Raporti i  
zbatimit të  
**Ligjit për ndalimin  
dhe mbrojtjen nga  
diskriminimi**  
2011 – 2018



Projekti "LNMD nën xhamin zmadhues: Ndjekja e zbatimit të ligjit të ri për ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi" është financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedonia. Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij botimi bie vetëm mbi autorët dhe organizatën që e ka pranuar grantin, dhe nuk reflekton domosdoshmërisht këndvështrimin dhe qëndrimet e fondacionit Shoqëria e Hapur – Maqedonia.

# Përmbajtja

		Pasqyrë e veprimit të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi 2011–2018	28
<b>I. Hyrja</b>	<b>9</b>		
<b>II. Korniza metodologjike</b>	<b>11</b>		
<b>III. Korniza nacionale juridike për mbrojtje nga diskriminimi</b>	<b>14</b>		
Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut	14		
Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës	14		
Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave	15		
Ligji për marrëdhënie pune	15		
Ligji për mbrojtjen e fëmijëve	16		
Ligji për mbrojtjen sociale	16		
Ligji për gjykatat	17		
Ligji për prokurorinë publike	17		
Kodi Penal	17		
Strategjia nacionale për barazi dhe mosdiskriminim (SNBMD) 2016–2020	18		
Pasqyrë e Ligjit për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit	19		
<b>IV. Vendosja institucionale e mekanizmave për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit</b>	<b>22</b>		
Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi	22		
Avokati i Popullit	22		
Gjykata Kushtetuese	23		
Gjykatat	23		
Përfaqësues për mundësitë e barabarta	24		
<b>V. Analiza e procedurës për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi</b>	<b>25</b>		
Struktura e KMD-së dhe sfidat	26		
Pasqyrë e veprimit të KMD-së në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2018	27		
		<b>VI. Gjetjet nga intervistat me anëtarët e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi</b>	<b>68</b>
		Qëndrimet për përhapjen e diskriminimit dhe parashtrësit e dorëzuara	68
		Ingjerenat e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi	69
		Problemet me të cilët janë ballafaquar anëtarët e Komisionit gjatë mandatit të tyre	74
		Përfitimet prej Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi	74
		Masat specifike për përmirësim të gjendjeve në lidhje me diskriminimin	75
		<b>VII. Konkluzionet</b>	<b>77</b>
		<b>VIII. Bibliografia</b>	<b>79</b>

## I. Hyrja

Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është një nga trupat kryesorë për barazi, që në bazë të ligjit të miratuar në vitin 2011, Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, u vendos si pjesë e kornizës institucionale për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit. Komisioni, çdo vit, që nga viti 2011 e këndej, përgatit raporte vjetore që japin një pasqyrë të funksionimit të tij dhe të zbatimit të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Edhe përkrah nevojës për analizim objektiv të funksionimit të Komisionit, për një periudhë të gjatë, megjithatë një raport i këtij lloji nuk ishte përgatitur, prandaj edhe nuk ekzistonte asnjë lloj indikacioni në cilën periudhë dhe në çfarë mase Komisioni e ka përparuar veprimtarinë e vet.

Shqetëson sidomos fakti që gjatë viteve të kaluar, parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi nuk kanë qenë prioritet për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por kjo çështje shqyrtohej dhe është vendosur vetëm nga ideja për plotësim të kriterëve politike për qasje në BE. Në një pjesë të madhe kjo mund të vërtetohet nga mosalokimi i financave për realizim efikas të mandatit të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe nga sigurimi i ndihmës teknike dhe financiare vetëm nga organizatat ndërkombëtare.

Pikërisht për shkak të kontekstit të tillë politik dhe me qëllim që të përparojnë dhe të mbrohen të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe të ketë mbrojtje nga diskriminimi, Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi nga viti 2010 dhe në vazhdim i ndjek gjendjet me mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus te zbatimi i LPMD-së, si dhe te funksionimi i KMD-së. Duke pasur parasysh se deri tani nuk është përgatitur një raport gjithëpërfshirës mbi funksionimin e KMD-së, Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi e pranoi sfidën që të përgatisë raport në të cilin do të analizohet veprimtaria e KMD-së për periudhën nga themelimi i saj deri më sot, duke përfshirë veprimtarinë e anëtarëve të Komisionit në të dy mandatet, nga viti 2011 deri në vitin 2016 dhe nga viti 2016 deri në vitin 2019.

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i funksionalitetit të mekanizmave ekzistues juridikë dhe institucionalë për mbrojtje nga diskriminim, me fokus te zbatimi i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (lex specialis) dhe funksionaliteti i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi. Analiza është pjesë e aksionit të përbashkët të Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për ndjekjen e procesit të harmonizimit të legjislacionit nacional me atë evropian në pjesën e antidiskriminimit. Duke pasur parasysh se në periudhën e kaluar është shtyrë miratimi i ligjit të ri për parandalim

dhe mbrojtje nga diskriminimi, analiza përmban të dhëna për kornizën ligjore dhe institucionale dhe zbatimin e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, i vitit 2010. Raporti i përgatitur jep një pasqyrë mbi punën e deritanishme gjithëpërfshirëse të KMD-së, i identifikon aspektet pozitive dhe negative të zbatimi të LPMD-së, kurse ai përbën, njëkohësisht, edhe bazë për krahasim të punës së mëtejshme të Komisionit të ri në realizimin e mandatit të tij të ri.

Raporti përbëhet nga tri tërësi të veçanta, tërësia e parë e shqyrton vendosjen e përhershme juridike dhe institucionale të mekanizmave për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit. Tërësia e dytë është fokusuar në analizimin e kompetencave të KMD-së, si edhe analizë të veprimit të saj në lidhje me ankesat e dorëzuara për çdo vit më vete me ilustrim të lëndëve më eklatante për mbrojtje nga diskriminimi. Tërësia e tretë jep pasqyrë të qëndrimeve dhe përvojave personale të anëtarëve të Komisionit në raport me gjendjet me diskriminimin në fillim të mandatit të tyre (të mëparshëm/ të tanishëm), krahasuar me gjendjen e sotshme, përkatësisht me përfundimin e mandatit të tyre, por edhe të përvojave të tyre në lidhje me punën e tërësishme të komisionit, si dhe rekomandimet për përparim të punës së tij të mëtejshme.

Të dhënat e marra kuantitative dhe kualitative të kthyerë në përfundime do të kontribuojnë në një masë të madhe në identifikimin e mesazheve për gjendjet dhe nevojat e dëshiruara në lidhje me faktin se në cilën mënyrë KMD-ja dhe anëtarët e ardhshëm të Komisionit duhet t'u përgjigjen sfidave ekzistuese dhe atyre të reja në lidhje me parandalimin, ndalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Analiza është përgatitur në suazat e projektit "Pjesëmarrja e shoqërisë qytetare në procesin e aderimit në BE" i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia.

## II. Korniza metodologjike

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i funksionalitetit të mekanizmave ekzistues juridikë dhe institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi, me fokus në zbatimin e ligjit ekzistues për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (lex specialis) dhe funksionaliteti i Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Korniza metodologjike e këtij raporti bazohet në desk-analizë, analizë juridike dhe analizë të intervistave me palët e prekur.

Desk-analiza e këtij raporti bazohet në burime dytësore të të dhënave. Ajo përfshin, mbledhje, kontroll dhe analizë të raporteve, analizave, dokumenteve dhe të dhënave që janë në dispozicion në lidhje me zbatimin e legjislatives dhe funksionalitetit të mekanizmave për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Si burime të të dhënave përdoren raportet, analizat, dokumentet dhe të dhënat e nxjerra nga institucione relevante (nga vendi dhe ato ndërkombëtare), raporte dhe analiza të organizatave joqeveritare dhe trupave për monitorim të punës së mekanizmave për mbrojtje dhe zbatim të legjislacionit të mosdiskriminimit, vepra akademike dhe burime nga mediat.

Analiza juridike bazohet në të dhënat parësore dhe dytësore dhe përfshin analizë të legjislacionit (lex specialis dhe dispozitat ligjore dhe normat në akte të tjera ligjore), zbatimin dhe praktikën e mbrojtjes dhe parandalimit të diskriminimit. Analiza përfshin një shqyrtim kritik të përparësive dhe mangësive ekzistuese në kornizën ligjore dhe të mekanizmave për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit, duke shqyrtuar veçanërisht Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Gjithashtu, analiza juridike përfshin edhe shqyrtim të studimeve ekzistuese juridike, raporteve dhe analizave për kornizën juridike dhe institucionale për mosdiskriminim.

Analiza e intervistave bazohet në të dhënat parësore, përkatësisht të informacioneve të mbledhura nga përfaqësuesit/përfaqësueset e intervistuar të mekanizmave institucionalë për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit. Për intervistat është përdorur një instrument i përgatitur - pyetësor gjysmë i strukturuar për intervistë thelbësore me ekzemplarë të qëllimshëm të përfaqësuesve të zgjedhur të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi. Pyetësi është përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë të dhëna cilësore të bazuara në përvojën e anëtarëve të Komisionit, në raport me faktin se a është përmirësuar puna e komisionit dhe në cilën masë është përmirësuar, si edhe për perceptimet e tyre për perspektivat e përparimit të punës së mëtejshme të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi. Intervista u janë bërë gjashtë anëtarëve të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi.

## Desk-analiza dhe analiza juridike i shqyrtojnë këto aspekte:

### Kornizën juridike nacionale për mbrojtje nga diskriminimi

Kjo pjesë e analizës jep shqyrtim të ligjeve që kanë për qëllim mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi. Raporti jep pasqyrë të legjislacionit që përmban normat dhe dispozitat në aspektin e mbrojtjes nga diskriminimi, siç është Kushtetuta e RMV-së, Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, Ligji për mbrojtje dhe shqetësim në vendin e punës, Ligji për marrëdhënie pune, Ligji për mbrojtje të fëmijëve dhe Kodi penal. Analiza përmban edhe një shqyrtim të përgjithshëm të Strategjisë për barazi dhe mosdiskriminim 2016-2020 dhe shqyrtim të pjesëve kryesore me fokus në qëllimet strategjike dhe lidhjen me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Analiza përfshin edhe shqyrtim kritik të përcaktimit të qëllimeve strategjike dhe të mundësive për zbatim në kornizën e dhënë kohore dhe buxhetore.

### Shqyrtim i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi

Në këtë pjesë të raportit analizohet Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi nëpërmjet dispozitave të përgjithshme, formave të diskriminimit dhe përjashtimit nga diskriminimi.

### Vendosja institucionale

Kjo pjesë e analizës kornizën më të gjerë institucionale me qëllim që të vlerësohet shkalla e mbrojtjes e paraparë me ligjin ekzistues për ndalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe mekanizmat që janë në dispozicion për mbrojtje nga diskriminimi. Korniza institucionale ka të bëjë me vendosjen e institucioneve në raport me zbatimin e ligjit. Në këtë pjesë është dhënë një pasqyrë e institucioneve që, në përputhje me ligjin, sigurojnë mbrojtje kundër diskriminimit dhe përgjegjësi e të cilave është që të hetojnë dhe të vërtetojnë se a ekziston diskriminim. Mandej, sipas informacioneve dhe studimeve në dispozicion kjo pjesë vlerëson a kanë institucionet kapacitete dhe autoritet që të veprojnë dhe me sa efektivitet e bëjnë këtë gjë.

### Analiza e procedurës për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi

Komisioni për Mbrojtje nga diskriminimi, i cili është një nga mekanizmat kryesorë të vendosur për mbrojtje nga diskriminimi, është analizuar në mënyrë kritike në lidhje me mënyrën e funksionimit në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2018. Kjo pjesë

e analizës jep pasqyrë të zbatimit të ligjit, efektet e zbatimit të ligjit në lidhje me paraqitjen në më tepër rasteve, a është përmirësuar vetëdija mbi diskriminim dhe pasqyrë kritike të numrit të rasteve që i janë dorëzuar Komisionit nga viti 2011 deri në vitin 2018.

### Intervista me anëtarë të tanishëm dhe të mëparshëm të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi

Përveç desk-analizës dhe analizës juridike janë bërë intervista me 6 (gjashtë) anëtarë të Komisionit, prej të cilëve dy kanë qenë anëtarë në përbërjen e mëparshme të Komisionit nga viti 2011 deri në vitin 2016, tri në përbërjen e tanishme të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi (2016-2019), kurse një nga anëtarët ka qenë anëtar edhe në mandatin e mëparshëm edhe në këtë mandat të KMD-së. Intervistat kishin si qëllim të përcaktojnë perceptimet dhe qëndrimet e anëtarëve të Komisionit në lidhje me gjendjet me diskriminim në fillim të mandatit të tyre (të mëparshëm/tanishëm) krahasuar me gjendjen e sotme, përkatësisht pas përfundimit të mandatit të tyre.

Intervistat ishin të drejtpërdrejta (sy më sy), janë dokumentuar me audioregjistrim me miratim nga personat e intervistuar. Gjetjet e analizës kualitative dhe interpretimi i intervistave janë përmbledhur në pjesën e fundit të raportit dhe kontribuojnë në identifikimin e rekomandimeve për gjendjet dëshiruara dhe nevojat për faktin se si dhe në ç'mënyrë KMD-ja dhe anëtarët e ardhshëm të Komisionit do të duhet t'u përgjigjen sfidave ekzistuese dhe të reja në lidhje me parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

### III. Korniza nacionale juridike për mbrojtje nga diskriminimi

#### Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Një nga vlerat themelore kryesore të rendit kushtetues së Republikës së Maqedonisë së Veriut janë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit, që njihen me të drejtën ndërkombëtare dhe përcaktohen nga Kushtetuta. Në përputhje me nenin 9 të Kushtetutës: “Qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pronësore dhe shoqërore. Qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve.” Në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve në nenin 50 të Kushtetutës parashikohet se çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese në procedurë të mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës.

Përveç parimit të barazisë, Kushtetuta në nenin 110 në mënyrë eksplicite e ndalon diskriminimin e qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, nacionale, sociale dhe politike.

**Parimi i barazisë është inkorporuar në shumë ligje të tjera nga fushat përkatëse, siç janë:** Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, Ligji për shqetësim në vendin e punës, Ligji për marrëdhënie pune, Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, Ligji për mbrojtjen sociale, Ligji i familjes, Ligji i arsimit fillor, Ligji i arsimit të mesëm, Ligji i arsimit të lartë, Ligji për gjykatat, Ligji për shëndetin publik, Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, Ligji i vullnetarizmit, Ligji për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet dhe ligje të tjera.

#### Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës

Në vitin 2013 është miratuar Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës, me të cilin u përcaktua baza sistematike për veprim parandalues dhe shqyrtim të rasteve të shqetësimit në vendin e punës. Neni 5 i këtij Ligji e përcakton terminologjinë e shqetësimit seksual dhe psikik në vendin e punës.

Mandej, ky ligj përmban edhe dispozita për mbrojtje dhe janë dhënë procedurat dhe mekanizmat që i kanë në dispozicion viktimat e shqetësimit në vendin e punës. Domethënë, ligji parashikon që të ketë mekanizëm të veçantë, kështu që mbrojtja fillon me të ashtuquajturën procedurë paraprake që zbatohet para punëdhënësit, i cili palëve të prekura u propozon ndërmjetësimin si mënyrë për zgjidhje të marrëdhënies kontestuese nëpërmjet zgjedhjes së një personi nga lista e ndërmjetësuesve. Nëse kjo procedurë nuk jep zgjidhje të suksesshme të marrëdhënies kontestuese, pala e dëmtuar ka në dispozicion procedurën për mbrojtje gjyqësore. Nëse gjatë procedurës paditëse e bën propabile ekzistimin e shqetësimit në vendin e punës, në atë rast barra e dëshimit se nuk ka pasur shqetësim në vendin e punës bie mbi të paditurin.

Ligji zbatohet te punëdhënësit, të punësuarit, kandidatët për punësim, si edhe personat e angazhuar me marrëveshje të cilët marrin pjesë në punë te punëdhënësi.

#### Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave

Me ligjin për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, i miratuar në vitin 2006, ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, shqetësimi dhe shqetësimi seksual. Njëkohësisht, në suazat e ligjit vendoset mekanizëm për mbrojtje të mundësive të barabarta midis grave dhe burrave. i ashtuquajtur përfaqësues i mundësive të barabarta. Përfaqësuesi është nëpunës shtetëror i punësuar në MPPS që ka për detyrë të udhëheqë procedurën për vërtetimin të trajtimit të pabarabartë.

Procedura e vërtetimit të trajtimit të pabarabartë të grave dhe burrave përfundon me dhënien e mendimit me shkrim ku jepet gjendja faktive të cilën e ka përcaktuar përfaqësuesi, përkatësisht se a ekziston trajtim i pabarabartë midis grave dhe burrave në përputhje me ligjin. Mendimin e shkrim përfaqësuesi ua dorëzon subjekteve të përfshira në procedurë.

Në vitin 2012 është miratuar një ligj i ri për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, i cili siguroi rregullim gjithëpërfshirës të vendosjes institucionale dhe kompetencës së makinerisë gjinore.

#### Ligji për marrëdhënie pune

Në përputhje me nenin 6 të këtij ligji: “Punëdhënësit nuk i lejohet kërkuesin e punës apo punëtorin ta vërë në pozitë të pabarabartë në varësi nga prejardhja etnike ose racore, ngjyra e lëkurës, gjinia, moshë, gjendja shëndetësore, përkatësisht invaliditeti, bindja fetare, politike e tjetër, anëtarësimi në sindikata, prejardhja nacionale ose sociale, statusi i familjes, gjendja pronësore, orientimi seksual apo rrethana të tjera personale.”



Ligji për marrëdhënie pune e përcakton diskriminimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë, shqetësimin, shqetësimin seksual dhe mobingun.

Mandej, Ligji i ndalon të gjitha format e diskriminimit të punëtores për shkak të shtatzënisë, lindjes apo prindërisë, pa marrë parasysh kohëzgjatjen dhe llojin e marrëdhënies së punës të vendosur përputhje me ligjin. Ndalimi i diskriminimit është edhe në lidhje me qasjen të punësimit, kushtet e punës dhe të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe dorëheqja nga marrëveshja për punësim i punëtoreve që janë shtatzëna apo shfrytëzojnë të drejta të cilat dalin nga lindja dhe prindëria.

Në raste të diskriminimit kandidati për punësim apo punëtori ka të drejtë të kërkojë kompensim të dëmtimit në përputhje me Ligjin për marrëdhënie të obligueshme.

### **Ligji për mbrojtjen e fëmijëve**

Ndryshime thelbësore në lidhje me diskriminimin janë futur në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve në vitin 2009. Domethënë, me këto ndryshime, në nenin 9 ndalohet diskriminimi në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, bindje politike apo bindje tjetër, prejardhjes nacionale, etnike apo sociale, përkatësisë kulturore apo tjetër, gjendjes pronësore, paaftësisë, lindje apo ndonjë status tjetër të fëmijë apo prindit të tij ose kujdestari ligjor, kurse neni 9-a e ndalon diskriminimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Njëkohësisht Ligji e rregullon edhe mundësinë për mbrojtje nga diskriminimi në procedurë administrative (9-ç), kurse neni 9-dh jep mundësi për mbrojtje nga diskriminimi edhe para gjykatave kompetente me kërkesë për përcaktim të diskriminimit, ndalimit apo largimit të diskriminimit dhe kompensim të dëmit.

### **Ligji për mbrojtjen sociale**

Ligji për mbrojtje sociale e rregullon parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, kështu që në nenin 16 thuhet se përdoruesi ka të drejtën e mbrojtjes sociale që bazohet në trajtimin e barabartë dhe të njëjtë. Njëkohësisht, i njëjti nen paragrafi 2 ndalon çfarëdo lloji dhe forme të diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë etnike apo nacionale, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë prejardhjes sociale, arsimit, fesë apo bindjes fetare, bindjes politike, bindjeje tjetër, kufizimeve, moshës, gjendjes familjare apo martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, pronës personale dhe statusit shoqëror apo cilësdo bazë tjetër në realizimin e ndihmës në të holla prej mbrojtjes sociale dhe shërbimeve sociale.

Ligji për mbrojtjen sociale parashikon edhe dispozita kundërvajtje, përkatësisht gjoba në shumë prej 1.000 eurosh në vlerë denari për kundërvajtje nga institucioni i mbrojtjes sociale apo person tjetër juridik nëse shfrytëzuesin e ndihmës sociale e vendos në pozitë të pabarabartë (neni 350).

### **Ligji për gjykatat**

Ky ligj, në nenin 3, përcakton se qëllimet dhe funksionet e pushtetit gjyqësor përfshijnë edhe sigurim të barazisë, drejtësisë dhe mosdiskriminimit në cilëndo bazë. Mandej, ligji përcakton se secili ka të drejtë për qasje të barabartë të gjykatat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe interesave me bazë juridike. Ligji përcakton se gjatë zgjedhjes së gjykatësve dhe gjykatësve porotë nuk lejohet të ketë asnjë lloj diskriminimi në bazë të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale apo sociale, bindjes politike dhe fetare, pozitës pronësore dhe shoqërore. Nëse gjykatësi e shkel parimin e mosdiskriminimit, kjo konsiderohet si shkelje më e rëndë e disiplinës për të cilën inicohet procedurë për përgjegjësi disiplinore të gjykatësit për shkarkim të tij.

### **Ligji për prokurorinë publike**

Neni 5 i Ligjit për prokurorinë publike përcakton se prokurori publik në kryerjen e funksionit siguron barazi para ligjit pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja nacionale dhe sociale, bindja politike dhe fetare dhe pozita pronësore dhe shoqërore. Ngjashëm si edhe në Ligjin për gjykatat shkelja e parimit të mosdiskriminimit konsiderohet si shkelje më e rëndë e disiplinës, kurse gjatë zgjedhjes së prokurorit publik ndalohet qartë diskriminimi.

### **Kodi Penal**

Shkelja e parimit të barazisë dhe drejtësisë është inkriminuar në nenin 137 të Kodit penal, sipas të cilit: “Ai i cili në bazë të dallimit të seksit, rasës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë nacionale dhe sociale, bindjes fetare dhe nacionale, pozitës pronësore dhe shoqërore, gjuhës apo ndonjë vetie apo rrethane tjetër personale, do t’i marrë apo kufizojë të drejtat e njeriut dhe qytetarit, të përcaktuara me Kushtetutë, ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar apo i cili në bazë të këtyre dallimeve u jep qytetarëve privilegje në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin apo marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar do të dënohet me burg nga tre muaj deri në tre vjet”.

Mbrojtja juridike-penale nga diskriminimi është paraparë edhe dhe veprën penale: Nxitje e urrejtjes nacionale racore dhe fetare, përçarjen dhe mostolerancën (neni 417 i KP-së).

## Strategjia nacionale për barazi dhe mosdiskriminim (SNBMD) 2016–2020

Pas miratimit të Strategjisë së parë për barazi dhe mosdiskriminim për periudhën 2012-2015, në maj të vitit 2016 Qeveria e RMV-së e miratoi strategjinë e dytë nacionale për barazi dhe mosdiskriminim. Me qëllim që të përcaktohen përparimi dhe arritjet në realizimin e strategjisë së parë nacionale, MPPS-ja, në bashkëpunim me misionin e OSBE-së, në vitin 2015 bëri evalvimin që i dha drejtimet e mëtejshme për strategjinë e re nacionale për periudhën 2016-2020.

Strategjia e re nacionale i përmban të gjitha bazat e diskriminimit, për dallim nga ajo e mëparshme që fokusohet në katër bazat për diskriminim (kufizimi fizik dhe mental, përkatësia etnike, mosha dhe seksi).

Është e rëndësishme të përmendim se kjo SNBMD përmban përpjekjet deklarative të Qeverisë për sigurim të mjeteve më të mëdha financiare për zbatimin e qëllimeve strategjike dhe aktiviteteve të parapara.

Strategjia nacionale për barazi dhe mosdiskriminim është dokument strategjik i Qeverisë së RMV-së që i përkufizon qëllimet, masat, indikatorët, kreatorët kryesorë të politikave për përparim të të drejtave dhe mundësive të barabarta, faktorët përgjegjës dhe të gjitha palët e prekura në vendosjen e barazisë dhe mosdiskriminimit.

- **Vizioni** – Realizimi i të drejtave të njeriut dhe vendosja e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi i të gjithë njerëzve në të gjitha fushat e jetesës shoqërore
- **Misioni** – Mbrojtje efikase nga diskriminimi dhe respektim i parimit të mundësive të barabarta dhe ndalimi i diskriminimit të cilitdo person dhe/ose grup njerëzish, në bazë të karakteristikave të tyre personale, sidomos grupet e lëndueshme sociale (gra, persona-LGBT, të moshuar, bashkësi etnike, persona me kufizime mentale dhe trupore, fëmijë, refugjatë, persona me status më të ulët social, të shpërngulur, si dhe grupe të tjera vunerabile, anëtarë të bashkësive fetare, dhe çdo person që është trajtuar ndryshe pa shkaqe të arsyeshme dhe qëllim legjitim).
- **Qëllimi i përgjithshëm** i Strategjisë nacionale për barazi dhe mosdiskriminim është parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi, që të ngihet shkalla e realizimit të të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta për të gjithë, në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore në nivel nacional dhe lokal.

## Strategjia nacionale për mbrojtje nga diskriminimi është shndërruar në tri qëllime specifike strategjike:

- **Qëllimi strategjik 1:** Përparimi i kornizës juridike për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.
- **Qëllimi strategjik 2:** Përforcimi i kapaciteteve, përparimi i punës dhe koordinimi i mekanizmeve institucionale për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe promovim i mundësive të barabarta.
- **Qëllimi strategjik 3:** Ngritja e vetëdijes publike në dallimin e formave të diskriminimit dhe promovimi i konceptit të mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta.

Korniza strategjike parashikon aktivitete të cilat synojnë realizimin e secilës prej qëllimeve strategjike të parapara, aktivitete për institucionet përgjegjëse, indikatorë për ndjekjen e zbatimit dhe ndjekjen e kornizës kohore.

## Pasqyrë e Ligjit për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit

Me miratimin e Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi<sup>1</sup> si lex specialis në vitin 2010 për herë të parë janë krijuar bazat e shumëpritura për ndërtim të shoqërisë inkluzive dhe të barabartë, si dhe për sigurim të mbrojtjes efikase dhe efektive ndaj diskriminimit të të gjithë qytetarëve. Domethënë, edhe përkrah iniciativave të sektorit qytetar dhe tekstit të përpiluar të propozim-ligjit për mosdiskriminim që në vitin 2006, ky ligj është miratuar katër vjet më vonë. Në bazë të ligjit të miratuar, më një janar 2011 është formuar Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, me mandat që ta promovojë barazinë e të gjithë qytetarëve dhe ti mbrojtë nga diskriminimi.

Zgjedhja e deritanishme ligjore nuk u përgjigj tërësisht të gjithave obligime të ndërmarra nga shteti para trupave ndërkombëtare dhe rajonal për të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës dhe komitetet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Prandaj, që të bëhet harmonizim i tërësishtëm i tij me standardet ndërkombëtare dhe rajonale për mbrojtje gjithëpërfshirëse të të drejtave të njeriut; Komisioni Evropian në Raportin e përparimit të RMV-së për vitin 2018<sup>2</sup> rekomandoi që të miratohet dhe të fillojë zbatimi i propozim-ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, kurse ligjet e tjera të harmonizohen me të.

1 Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, "Gazeta zyrtare e RMV", nr. 101/2019.

2 <https://www.sobranie.mk/content/republic-of-macedonia-report%2017.4.18.pdf>

Me miratimin e Ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi<sup>3</sup> janë tejkuluar mangësitë e konstatuara më poshtë:

**1. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk ishin vendosur si bazë për diskriminim në nenin 3 të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.**

Nevoja e përfshirjes së këtyre bazave është edhe më shumë e arsyeshme dhe logjike duke pasur parasysh faktin se nga viti 2005 deri më sot janë miratuar tetë ligje nga fusha të ndryshme të cilat e përfshijnë orientimin seksual si bazë diskriminimi. Me miratimin e ligjit të ri, këto dy baza janë integruar në nenin 5 të tij.

**2. Barra e dëshimit** nuk ishte rregulluar si duhet në LPMD-në e deritanishme, përveç dhënies së të gjithë fakteve, të japë edhe dëshmi që e arsyetojnë pohimin e saj. Zgjidhja e re ligjore parashikon që dorëzuesi i parashtrësës (neni 26) dhe paditësi (neni 37) janë të obliguar të japin vetëm të gjitha faktet që e bëjnë pohimin për diskriminim propabil, mandej barre e dëshimit i kalon palës tjetër.

**3. Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk i plotësonte standardet e pavarësisë, profesionalizmit dhe ekspertizës. Një nga negativitetet e përcaktuara në veprimtarinë e KMD-së ishte edhe mungesa e konsistencës në vendime, kurse në raste për të cilat trupat e tjerë për barazi kanë konstatuar diskriminim, Komisioni nuk ka vërtetuar diskriminim.** Prandaj, një nga rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Komitetit për të Drejta Ekonomike, Kulturore dhe Sociale rekomanduan profesionalizim të këtij trupi dhe garanci më të fuqishme për pavarësinë politike dhe financiare në përputhje me Parimet e Parisit<sup>4</sup>. Praktika e deritanishme dëshmoi se anëtarët e komisionit janë zgjedhur në mënyrë jotransparente, ekspertiza e tyre ishte problematike dhe ata ishin të njëanshëm në dhënien e mendimeve. Anëtarët e komisionit merrnin honorar mujor dhe ata takoheshin njëherë në javë që të vendosin për parashtrësat e dorëzuara. Zgjidhja e tanishme ligjore parashikon kriteret më të larta të profesionalizmit, ekspertizës dhe përvojës në këtë fushë duke u siguruar kështu profesionalizëm i komisionit. Anëtarët e komisionit, në vend që të jenë të angazhuar, do të jenë të punësuar me orar të plotë pune që do të kontribuojë në realizimin efikas të spektrit të zmadhuar të kompetencave. Mandej, me qëllim që të garantohet pavarësia politike, neni 19 i ligjit të ri parashikon se funksioni anëtar i komisionit është inkompatibil me kryerjen e ndonjë funksioni, profesioni tjetër publik ose funksion në parti politike. Transparenca gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të rinj do të sigurohet nëpërmjet shpalljes publike në tri gazeta ditore minimum, që botohen në territorin e shtetit.

<sup>3</sup> Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi "Gazeta Zyrtare e RNV-së", nr. 101/2019.

<sup>4</sup> Principles relating to the Status of National Institutions (The Paris Principles) Adopted by UN General Assembly resolution 48/134 of 20 December 1993.

**4. Mosekzistimi i shërbimit profesional-administrativ.** Ligji i deritanishëm parashikonte që punët profesionale-administrative dhe teknike t'i kryente komisioni. Zgjidhja e tanishme ligjore parashikon formimin e shërbimit profesional për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit (neni 22).

**5. Nevoja për zmadhim të kompetencave të komisionit.** Ligji i ri parashikon zmadhim të spektrit të kompetencave të Komisionit, kështu që ai do të jetë i obliguar të ndër marrë aktivitetet për promovim të parimit të barazisë, të ndër marrë aktivitetet për parandalim të diskriminimi, të vendosë procedura gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, si edhe ta ndjekë zbatimin e mendimeve dhe rekomandimeve për raste konkrete të diskriminimit deri në plotësim të tyre.

**6. Veprimtaria pa efikasitet në procedurat për përcaktim të diskriminimit.** Komisioni në pjesën më të madhe të rasteve e ka shkelur afatin prej 90 ditësh për vendimmarrje. Me ligjin e ri me shkurtimin e afatit në 60 ditë do të mundësohet veprim efikas për parashtrësat për mbrojtje nga diskriminimi.

**7. Mungesa e sistemit për pavarësi financiare të komisionit me qëllim që të zvogëlohen rreziqet e ndikimit mbi punën e tij.** Deri më tani, Komisioni nuk ka pasur buxhet personal, por kanë ekzistuar vetëm alokacione buxhetore për kompensime mujore për anëtarët e tij. Ligji i ri parashikon dhe garanton përdorim dhe shpërndarje të pavarur të mjeteve për punën e Komisionit (neni 15)

**8. Personat të cilët i zbatonin procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi nuk kanë qenë të çliruar nga pagesa e taksave gjyqësore.** Zgjidhja e re ligjore parashikon që shpenzimet për pagim të taksave gjyqësore, në vend që të jenë barrë e personave të cilët i ngrenë procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, do të jenë barrë e Buxhetit të shtetit (neni 39).

**9. Nuk ekzistonte mundësi për ngritje të padive për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik (action popularis) pa pajtueshmëri të viktimës.** Deri më tani, padija e përbashkët për mbrojtje nga diskriminimi lejohej vetëm nëse ekziston pajtueshmëri nga personi i cili pohon se është diskriminuar. Zgjidhja e re ligjore parashikon mundësi që shoqatat e qytetarëve, fondacionet, sindikatat apo organizatat e tjera të shoqërisë qytetare dhe grupet joformale që kanë interes të arsyetueshëm për mbrojtje të interesave të një grupi të caktuar apo në suazat e veprimtarisë së vet merren me mbrojtje nga diskriminimi, të ngrenë padi, nëse e bëjnë propabile se me veprimin e të paditurit diskriminohet një numër më i madh personash, kurse gjatë kësaj nuk kërkohet ekzistim i viktimës individuale (neni 35). Njëkohësisht, ligji i ri në nenin 38 jep mundësi që në procedurën gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi të përdoren edhe të dhëna statistikore dhe/ose të dhënat e marra nga testimi i situatës së diskriminimit.

## IV. Vendosja institucionale e mekanizmave për mbrojtje dhe parandalim të diskriminimit

### Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi

Pas miratimit të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2010, në vitin 2011 është formuar Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komisioni në përputhje me ligjin, është person juridik i pavarur dhe sovran i cili është themeluar që të veprojë vetëm për çështje që lidhen me diskriminimin, përkatësisht vepron për parashtrësia kundër të gjithë personave juridikë dhe fizikë.

Ai është me seli në Shkup, por është kompetent të pranojë dhe të veprojë për parashtrësia nga i gjithë territori i shtetit. Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë që votohen nga Kuvendi i RMV-së.

Mandati i parë pesëvjeçar i anëtarëve të Komisionit në suazat e KMD-së ishte në periudhën 2011-2016, kurse mandati i anëtarëve të tanishëm të Komisionit filloi në vitin 2016. Nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi përfundon mandati i anëtarëve të Komisionit, kurse ata mund të vazhdojnë me punë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, por jo më gjatë se tre muaj.

Mendimet e Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk kanë veprimtari juridike-obliguese.

### Avokati i Popullit

Avokati i Popullit është organ i RMV-së që i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur ato u shkelen me akte, veprime dhe lëshime të veprimeve nga organet e administratës shtetërore dhe organet dhe organizatat e tjera që kanë autorizime publike dhe i cili ndërmerr veprime dhe masa për mbrojtje të parimeve të mosdiskriminimit dhe përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të përfaqësuesve të bashkësive në organet e pushtetit shtetëror, organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe organeve të institucioneve dhe shërbimeve publike. Avokati i Popullit e kryen funksionin e tij nëpërmjet gjashtë zyrave rajonale në shtet.

Në përputhje me nenin 13 të Ligjit, çdo person mund të dorëzojë parashtrësia tek Avokati i Popullit kur do të vlerësojë se të drejtat e tij kushtetuese dhe ligjore janë shkelur ose kur janë shkelur parimet e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit përkatës të drejtë të anëtarëve të bashkësive.

Mandati i Avokatit të Popullit shtrihet vetëm në organet e pushtetit shtetëror, por jo edhe nëse shkelësi është person privat, juridik ose fizik. Në këto raste personi mund të dërgojë parashtrësia në KMD.

Mendimet dhe rekomandimet e AP-së nuk kanë veprim juridik-obligues.

### Gjykata Kushtetuese

Në përputhje me nenin 113 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është e autorizuar të veprojë ndaj kërkesave individuale për mbrojtje të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ky mjet juridik është instanca e fundit juridike në grupin e mjeteve juridike vendase që qytetarët mund t'i shfrytëzojnë për mbrojtje nga diskriminimi. Procedura në bazë të së cilës Gjykata Kushtetuese është kompetente të kryejë mbrojtjen e drejtpërdrejtë të lirive dhe të drejtave, si dhe mbrojtjen nga diskriminimi është rregulluar me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së.

Edhe përkrah mekanizmit të vendosur për mbrojtje, qytetarët e përdorin rrallë këtë formë të mbrojtjes.

### Gjykatat

Në përputhje me Kushtetutën, çdo qytetar ka mundësi t'u drejtohet për mbrojtje të lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë gjykatave kompetente në procedurë të bazuar në parimet e prioritetit dhe urgjencës. Njëkohësisht, në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, gjykatat janë të obliguara në procedurë urgjente të marrin vendime në procedurat për mbrojtje nga diskriminimi prej të cilave dalin pasojat juridike për personin e paditur, përkatësisht personin që ka kryer diskriminim. Në procedurën për mbrojtje nga diskriminimi, përveç gjykatës me kompetencë të përgjithshme vendore, kompetente është gjykata në rajonin e të cilës është vendbanimi, përkatësisht selia e paditësit. Numri i lëndëve gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi është ende në nivel të pakënaqshëm.



## **Përfaqësues për mundësitë e barabarta**

Në përputhje me Ligjin për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, personi të cilit i është shkelur e drejta e trajtimit të barabartë në bazë të gjinisë mund të dorëzojë parashtrësë të përfaqësuesi për mundësi të barabarta. Përfaqësuesi për mundësi të barabarta është nëpunës shtetëror i punësuar në MPPS dhe i obliguar të udhëheqë procedurën për përcaktim të trajtimit të pabarabartë midis grave dhe burrave.

Parashtrësë mund të dorëzojë çdo person fizik ose juridik, personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar, me shkrim, me gojë në procesverbal ose formë tjetër, telefaks ose nëpërmjet postës elektronike. Për parashtrësë të paraqitur me gojë përpilohet shënim zyrtar. Parashtrësja dorëzohet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e kur kuptohet se bëhet fjalë për akt diskriminimi ose maksimum një vit nga dita kur është kryer shkelja. Përfaqësuesi mund të ngrejë procedurë edhe me iniciativë të vet. Pas përfundimit të gjendjes faktike, përfaqësuesi përgatit mendim me shkrim në afat prej 90 ditësh.

Mendimi me shkrim përmban arsyetim për trajtimin e përcaktuar për pabarazi në bazë të gjinisë dhe rekomandim për mënyrën e largimit të shkeljes së të drejtës. Personi për të cilin është rekomandimi është i obliguar të veprojë sipas tij dhe ta largojë shkeljen në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të mendimit dhe për këtë ta informojë përfaqësuesin.

Edhe përkrah mekanizmit ligjor për mbrojtje të përcaktuar saktësisht, në praktikë ai nuk është funksional dhe nuk duket sa duhet. Konkretisht, nga viti 2014 në këtë pozitë nuk ka përfaqësues për mundësi të barabarta. Prandaj, janë jashtëzakonisht të rralla raste kur parashtrësat e tilla për shkelje të së drejtës së trajtimit të pabarabartë i janë dorëzuar këtij mekanizmi për mbrojtje.

## **V. Analiza e procedurës për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi**

Procedura para Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi fillon me dorëzimin e parashtrësës që mund të dorëzohet nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe organet shtetërore dhe organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale. Parashtrësja duhet të përmbajë të dhëna për personin që e dorëzon, përshkrim të mënyrës se si është bërë diskriminimi, kush e ka bërë veprimin e diskriminimit dhe baza e diskriminimit. Duke pasur parasysh se KMD nuk vepron për parashtrësja anonime, parashtrësja duhet të jetë e nënshkruar me patjetër. Mandej, ajo mund të dorëzohet në formë me shkrim ose me gojë me procesverbal, pa obligim për pagesë të çfarëdo lloj takse apo ndonjë kompensim tjetër nga dorëzuesi.

Nëse personi bën parashtrësë me shkrim, ai mund ta dorëzojë atë me postë, personalisht në hapësirat e Komisionit, si dhe me postë elektronike. Së bashku me parashtrësën, personi paraqet dëshmi dhe fakte prej të cilave mund të vërtetohet akti ose veprimi diskriminues. Pas pranimit të parashtrësës, Komisioni përcakton situatën faktike duke shqyrtuar dokumentet e paraqitura nga dorëzuesi dhe duke marrë deklaratë nga dorëzuesi dhe nga personi kundër të cilit është dorëzuar parashtrësja, por edhe nga palët e treta, nëse është e nevojshme. Personi kundër të cilit është dorëzuar parashtrësja mund të deklarohet për konstatimet e parashtrësës në afat prej 15 ditësh nga marrja e saj, kurse nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, Komisioni do ta pranojë heshtjen si pëlqim për pohimet e bëra në parashtrësë. Gjatë përcaktimit të situatës faktike, Komisioni u drejtohet të gjithë personave dhe institucioneve të tjera relevante, fizike dhe juridike, në përputhje me nevojat e rastit konkret, ndërsa nëse kërkohen informacione të mëtejshme në përputhje me nenin 31 dhe nenin 32 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioni i ndërmerr të gjithë hapat, me qëllim që të përcaktojë drejt gjendjen faktike dhe për të zgjidhur në kohë rastet, ndërsa kur është e nevojshme, bën edhe testimë përkatëse, mbledh të dhëna statistikore dhe të tjera.

Komisioni jep mendim mbi diskriminimin e pretenduar brenda 90 ditësh nga dita e dorëzimit të parashtrësës dhe për këtë e informon dorëzuesin e parashtrësës dhe personin kundër të cilit është dorëzuar parashtrësja. Nëse Komisioni konstaton se

ka diskriminim, rekomandon mënyrë/mënyra për heqjen e tij, kurse personi të cilit i drejtohet rekomandimi është i detyruar, brenda 30 ditësh nga data e marrjes së rekomandimit, të veprorë sipas tij dhe të korrigjojë shkeljen, si dhe ta informojë Komisionin për shkeljen e hequr. Nëse nuk vepron sipas rekomandimit brenda afatit të përcaktuar, d.m.th. nuk eliminon shkeljen e së drejtës, Komisioni mund të fillojë iniciativë për ngritje të procedurës tek organi kompetent për përcaktim të përgjegjësisë së tij.

### Struktura e KMD-së dhe sfidat

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi filloi me punë si subjekt juridik i pavarur dhe sovran më një janar 2011. Në përputhje me Ligjin për realizimin e veprimeve nga kompetenca e vet, Komisioni mund të formojë edhe trupa pune dhe komisione të brendshme të përkohshme ose të përhershme, kurse mjetet për punën i dorëzon nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, por ato mund t'i sigurojë edhe nga burime të tjera. Komisioni është e përbërë nga shtatë anëtarë, të cilët janë të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë prej pesë vjetësh, me mundësi për rizgjedhje.

Edhe pse në nenin 33 të Rregullores së Komisionit thuhet se “për kryerje të punëve profesionale, administrative dhe teknike, Komisioni formon shërbim profesional që do të jetë në hapësirat e Komisionit, ku do të ketë person profesional i cili do të jetë përgjegjës për pranimin e parashtrësive, për arkivimin dhe për pranimin e palëve”, në praktikë kjo nuk është realizuar asnjëherë. Megjithatë, Komisioni si person juridik nëpër vite provon të gjejë mënyra për angazhim të personave administrativë nëpërmjet projekteve ose nëpërmjet personave të cilët me autorizim të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale i kryejnë nevojat administrative të Komisionit.

Një prej parakushteve themelore për funksionimin përkatës të KMD-së është vendosje e tij si organ i pavarur dhe sovran që do të japë mbrojtje në raste të diskriminimit. Në këtë drejtim, ekziston një sërë sfidash në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit dhe profesionalizmin dhe përshtatshmërinë që të jenë pjesë e përbërjes që do të vendosë për parashtrësirat për diskriminim. Problemi shfaqet së pari në mungesën e rregullimit ligjor të papajtueshmërisë së ushtrimit të funksionit anëtar në KMD me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër. Kjo nënkupton se një pjesë e anëtarëve të Komisionit të cilët janë zgjedhur në KMD ushtrojnë njëkohësisht funksion tjetër në një organ shtetëror apo në një institucion shtetëror. Mandej, për anëtarët e Komisionit nuk vendosen asnjë lloj kushtesh në aspektin e përvojës me punë në fushën e të drejtave të njeriut dhe diskriminimit, që është mjaft problematike dhe e vë në pikëpyetje kompetencën e tyre. Pavarësia e KMD-së vihet në pikëpyetje kur shqyrtohet financimi i këtij komisioni dhe buxheti, që ndahet nga funksionimi i tij. Domethënë, buxheti i KMD-së është shumë i kufizuar dhe mjaft i vogël që të mund të realizohen si duhet aktivitetet për të cilat është kompetent Komisioni dhe duhet të

funksionojë pa pengesa. Në krahasim me komisionet e tjera, për funksionimin e këtij komisioni jepen shumë më pak mjete financiare për realizimin e aktiviteteve. Buxheti i kufizuar, de fakto, e pengon Komisionin që t'i realizojë tërësisht aktivitetet e veta, sidomos ato që lidhen me promovimin, hulumtimin dhe dukshmërinë.<sup>5</sup>

Si problem shtes shfaqet edhe mungesa e mbështetjes administrative-teknike e Komisionit, përkatësisht Sekretariati që do t'i kryejë punët administrative teknike në suazat e këtij trupi, prandaj pritet që anëtarët e Komisionit t'i kryejnë punët administrative-teknike. Mosekzistimi i kësaj mbështetjeje kontribuon që Komisioni të dështojë si mekanizëm efektiv për mbrojtje nga diskriminimi.<sup>6</sup>

Puna e Komisionit realizohet nëpërmjet seancave dhe takimeve të punës, kurse ajo prezantohet nga kryetari. Kryetari, një herë në muaj, me iniciativë personale apo me propozim nga ndonjë anëtar tjetër i Komisionit, thërret dhe drejton mbledhjet.


### Pasqyrë e veprimit të KMD-së në periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2018

Së pari, nuk mund të anashkalohej dhe të mos përmendet se numri i parashtrësive ndryshon nëpër vite, por në asnjë rast nuk e reflekton nivelin real të diskriminimit në Maqedoni. Qytetarët nuk janë të motivuar sa duhet që të paraqesin diskriminimin dhe prandaj nevojiten masa në drejtim të nxitjes së qytetarëve që të paraqesin rastet e diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. Një pjesë e arsyeve pse një numër i vogël i qytetarëve të cilët janë diskriminuar vendosin të dorëzojnë parashtrësia te Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi lidhen me mungesën e besimit në institucionet shtetërore, viktimizimin dytësor dhe mungesën e informacioneve se ekziston KMD-ja. Në vitet e para të formimit të Komisionit, numri i parashtrësive shënon trend të rritjes deri në vitin 2014, kurse nga viti 2015 numri i parashtrësive ulet në mënyrë drastike. Zmadhimi më i madh vihet re vetëm në vitin 2018, kur numri i parashtrësive nga 59 në vitin 2017, zmadhohet në 132 në vitin 2018.

<sup>5</sup> Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, 2013, f. 22.

<sup>6</sup> Raporti në hije për Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi, QHKP, 2012, f. 39.

**Tabela 1:** Numri i parashtrësive të dorëzuara në KMD nga viti 2011 deri në vitin 2018



**Pasqyrë e veprimit të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi 2011-2018**

**Veprimtaria e KMD-së në vitin 2011**


Në vitin e parë të Komisionit konsiderohet si periudha kur bëhej testimi i punës së këtij trupi si mekanizëm për mbrojtje nga diskriminimi. Këtë vit Komisioni i tejkaloi pritjet në aspektin e numrit të parashtrësive të dorëzuara, që arriti numrin prej 60. Megjithatë, njëkohësisht, ky trup u ballafaqua edhe me vështirësi të shumta. Siç është vendosur në pjesën e strukturës dhe sfidave me të cilat u ballafaqua KMD-ja, vështirësitë lidhen me kapacitetet e Komisionit, profesionalizmin, mungesën e mbështetjes administrative-teknike, përkatësisht Sekretariatit, buxhetin e kufizuar dhe të vogël, si dhe centralizimi dhe mungesa e zyrave rajonale. Në mënyrë të ilustruar, buxheti i Komisionit në vitin 2011 ka qenë 3.566.000 denarë, që është shpenzuar i gjithi vetëm për rroga dhe shpenzime komunale, kurse Komisionit i mbetën edhe obligime të pashlyera. Edhe pse kanë ekzistuar këto vështirësi, Komisioni në vitin 2011 ka pranuar 60 parashtrësia për diskriminim, prej të cilave ka zgjidhur 34 parashtrësia, por vetëm në pesë raste, pas përcaktimit të gjendjes faktike, ka konstatuar se ekziston diskriminim. Ky është tregues se që në vitin e parë të krijimit të Komisionit, një prej dobësive dhe mangësive të tij më të mëdha, që do të jetë evidente edhe në vitet në vijim, është veprimi dhe vendimmarrja për parashtrësia në afatin e paraparë ligjor. Për 10 raste Komisioni ka konstatuar se nuk ekziston diskriminim, kurse për 15 parashtrësia nuk ka vepruar fare<sup>7</sup>, kurse prej tyre,

<sup>7</sup> Komisioni nuk vepron në tri raste: 1. Nëse është e qartë se nuk ekziston shkelje e të drejtës për të cilën i drejtohet dorëzuesi; 2. Nëse Komisioni ka vepruar më parë për të njëjtën lëndë, por nuk janë dhënë dëshmi të reja; 3. dhe nëse Komisioni vërteton se për shkak të kalimit të afatit që kur është bërë shkelja e të drejtës nuk mund të arrihet qëllimi i procedurës.

në nëntë raste është e qartë se nuk ekziston shkelje e të drejtës për të cilën është ankuar dorëzuesi i parashtrësës, në pesë raste është vërtetuar se ka kaluar afati i shkeljes së të drejtës, kurse nuk ka mundësi të arrihet qëllimi në procedurë, si edhe në një rast kur procedura në gjykatë për të njëjtën gjë tashmë është ngritur apo është në fuqi.<sup>8</sup> Në katër nga pesë raste ku Komisioni ka konstatuar se ka diskriminim dhe ka dhënë mendime dhe rekomandime për largim të diskriminimit, diskriminuesit kanë vepruar vullnetarisht dhe i kanë korrigjuar shkeljet e të drejtave të dorëzuesit të parashtrësës. Është interesante se në rastin kur diskriminuesi nuk e ka korrigjuar shkeljen vullnetarisht, Komisioni e ka këshilluar dorëzuesin e parashtrësës për hapat e mëtejshëm juridike që mund t'i ndërmarrë që ta mbrojë të drejtën e vet, por nuk e ka shfrytëzuar autorizimin ligjor për ngritje të iniciativës për dorëzim të procedurës te organi kompetent, për përcaktim të përgjegjësisë së personit i cili nuk vepron sipas rekomandimit të Komisionit.<sup>9</sup>

Në aspektin e bazave, shumica e parashtrësive, përkatësisht 15, janë në bazë të përkatësisë politike, 13 parashtrësia janë në bazë të përkatësisë etnike, nëntë në bazë të statusit personal dhe shoqëror, gjashtë janë në bazë të prejardhjes sociale, pesë në bazë të gjinisë, pesë në bazë të kufizimit mendor dhe fizik, katër janë në bazë të moshës, katër janë në bazë të statusit të pronës, katër në bazë të seksit, tre në bazë të përkatësisë në grup të marginalizuar, tre në bazë të gjendje familjare dhe martesore dhe një parashtrësë në bazë të shtetësisë, arsimit, gjendje shëndetësore, si edhe lloje të tjera të bindjes.

**Tabela 2:** Numri i parashtrësive të ndara sipas bazave të ndryshme për vitin 2011




<sup>8</sup> Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2011.

<sup>9</sup> Neni 29 i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/2010).

Në aspektin e fushave ku dorëzuesit thonë se është kryer diskriminim, fusha më e përfaqësuar është fusha e punës dhe marrëdhënieve të punës me 30 parashtresa, kurse mandej ndjek siguria me 11 parashtresa, gjyqësori dhe drejtoria me tetë parashtresa, arsimit, shkenca dhe sporti me gjashtë parashtresa, qasja te të mirat dhe shërbimet me katër parashtresa, informim publik dhe media me dy parashtresa dhe fusha tjetër me tri parashtresa.

Tabela 3: Parashtresa të dorëzuara sipas fushave për vitin 2011



## Praktika

Rasti i parë për të cilin Komisioni ka përcaktuar diskriminim ishte rasti për parashtresën e Koalicionit “Të drejta seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara”, që është dorëzuar për shkak të përmbajtjes shqetësuese në librin shkollor të pedagogjisë për klasën e III të arsimit të mesëm, në bazë të orientimit seksual. Njëkohësisht kjo është parashtresa e parë e Rrjetit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe është me rëndësi të jashtëzakonshme për praktikën juridike, por edhe për përparimin e të drejtave të personave LGBTI, sepse për herë të parë si bazë diskriminuese është vendosur orientimi seksual, por nëse merren parasysh rrethanat në të cilat është miratuar LPMD-ja, mendimi i dhënë vendosi një praktikë të caktuar të Komisionit - edhe pse në LPMD, orientimi seksual nuk është vendosur saktësisht si bazë për diskriminim. Duke vepruar për këtë parashtresë, Komisioni ka kryer interpretim dhe zbatim të Ligjit, në kuptim të tillë se edhe orientimi seksual mund të jetë bazë për diskriminim. Në këtë mendim, Komisioni përcakton se përmbajtja në librin e kontestuar “Pedagogjia”, pjesa ku thuhet se “homoseksualiteti dhe lezbiket janë variante të epshit seksual dhe, gjithsesi, si llumra manifestohen me kthim të individit kah partnerit seksual të të njëjtit seks... Midis personave të orientuar dhe në të dyja sekset ka shumë persona neurotikë dhe psikotikë” është shqetësuese dhe shkakton ndjenjë të ofendimit dhe shkeljes së dinjitetit të një grupi

njerëzish, që rrjedh nga baza diskriminuese. Mendimi i Komisionit, i cili përcaktoi se ekziston diskriminim, mund të kuptohet si hap i guximshëm dhe vendimtar në mbrojtjen e personave LGBTI. Por, siç do të shohim mandej, Komisioni nuk i qëndroi konzistent praktikës së vet.

Që në vitin e parë të ekzistimit të Komisionit ishte vënë në testim pavarësia dhe paanësia e tij. Domethënë, Koalicioni “Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore për Grupet e Margjinalizuara” dorëzoi parashtresë te Komisioni kundër gazetës “Veçer” dhe kundër redaktorit Dragan Pavloviq-Llatas<sup>10</sup>, për shkak të botimit të artikullit me titull “Flamuq” (18.10.2010), i cili në momentin e dorëzimit të parashtresës ishte ende në dispozicion të lexuesve të botimit në internet. Artikulli përmban gjuhë diskriminuese homofobike të urrejtjes: “pederët janë kërcënim për njerëzimin”; “çdo peder duhet të mbajë bluzë se seksi me të mund të sjellë SIDË dhe se është kërcënim absolut për natalitetin”; “nëse dikush provokon me imponim të intimes së vet mbi nervat e të tjerëve, pa konkurrencë këta janë pederët” etj. Në parashtresë kërkohej nga Komisioni të vërtetojë diskriminim dhe të japë rekomandim për heqje të artikullit nga botimi në internet, sepse teksti krijon ende mjedis kërcënues dhe frikësues për personat që janë me orientim joheteroseksual, por edhe për personat që jetojnë me HIV/SIDË. Komisioni e ja hedhur poshtë parashtresën me arsyetimin se artikulli është botuar para se të krijohet Komisioni dhe prandaj ai nuk është kompetent të veprojë për të. Qëndrimi i tillë i Komisionit është në kundërshtim me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, por edhe me praktikën e vendosur deri tani për marrje të vendimeve. Domethënë, sipas neni 25 paragrafi 5 i ligjit të atëhershëm për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi parashtresa mund të dorëzohet maksimum tri ditë nga dita kur është kryer shkelja ose maksimum një vit pasi është bëri i njohur akti i diskriminimit. Parashtresa në fjalë është dorëzuar menjëherë pasi është mësuar se ky artikull është në internet, që ishte në periudhën kur është formuar Komisioni dhe kishte kompetencë. Gjithashtu, Komisioni kishte vendosur tashmë për librin shkollor “Pedagogjia” që ishte botuar në vitin 2005 duke konstatuar se zbatimi i tij shkakton diskriminim, që hedh dyshim mbi pavarësinë dhe paanësinë e Komisionit.<sup>11</sup>

Një rast strategjik dhe jashtëzakonisht i rëndësishëm që ishte nisur në vitin 2011 është rasti me segregimin e fëmijëve Romë në pesë shkolla në Manastir. Për arsye se për këtë rast Komisioni ka dhënë mendim pas tre vjetësh dhe pesë muajsh, ai do të arsyetohet në pjesën që ka të bëjë me punën e Komisionit për vitin 2014.

<sup>10</sup> Dragan Pavloviq-Llatas në këtë periudhë është redaktor në TV “Sitell”, televizion që mbahej si i afërt me partinë e atëhershme në pushtet.

<sup>11</sup> Raport i Rrjetit për Mbrojtje nga diskriminimi nga viti 2011 deri në vitin 2013, mars 2014.



## Veprimtaria e KMD-së në vitin 2012

Gjatë viti 2012 në KMD janë dorëzuar 75 parashtresa, prej të cilave Komisioni ka zgjidhur 43. Pjesa më e madhe e parashtresave të dorëzuara kanë të bëjnë me diskriminim nga organet shtetërore dhe institucionet publike, që është tregues për shkallën e lartë të mosrespektimit të parimit të mosdiskriminimit nga faktorët të cilët janë të obliguar të veprojnë njësoj me të gjithë qytetarët.

Nga parashtresat e dorëzuara mund të shihet se diskriminimi nga individë më shpesh është kryer me vetëdije, ky me deklaratë apo sjellje të caktuara shkelet dinjiteti i një personi apo grup personash për shkak të karakteristikave të tyre personale. Shpesh, sjellja e tillë është e motivuar nga urrejtja për grupe të caktuara të marginalizuara.


Shumica e parashtresave janë dorëzuar nga persona fizikë, 65 gjithsej, mandej nga persona juridikë - 22 parashtresa, kurse nga numri i përgjithshëm i parashtresave, 29 janë dorëzuar nga shoqata dhe organizata qytetare. Në lidhje me gjininë e dorëzuesve, 50 parashtresa janë dorëzuar nga burra, kurse 37 parashtresa janë dorëzuar nga gra.<sup>12</sup> Në 55 parashtresa nga numri i përgjithshëm, është vendosur vetëm një bazë diskriminimi, kurse në 22 parashtresa janë vendosur më tepër baza.

Në aspektin e bazave, shumica e parashtresave në vitin 2012 kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike, përkatësisht 16, në bazë të gjendjes shëndetësore janë dorëzuar 12 parashtresa, në bazë të përkatësisë në grup të marginalizuar janë dorëzuar 11 parashtresa, në bazë të statusit personal dhe shoqëror janë dorëzuar dhjetë, në bazë të aftësive të kufizuara mentale dhe trupore janë dorëzuar nëntë, në bazë të arsimit shtatë, numri i njëjtë është edhe në bazë të prejardhjes sociale, përkatësisht shtatë, në bazë të seksit janë dorëzuar dhjetë parashtresa gjithsej, në bazë të fesë dhe bindjes fetare tre gjithsej, në bazë të përkatësisë politike 3 parashtresa, në bazë të moshës gjithashtu 3 parashtresa, në bazë të gjendjes familjare dhe martesore 3, në bazë të gjinisë 2, në bazë të llojeve të tjera të bindjeve janë 2, në bazë të statusit pronësor është dorëzuar 1 parashtresë, kurse në baza të tjera janë dorëzuar 6 parashtresa gjithsej. Mandej, janë dorëzuar edhe 11 parashtresa ku dorëzuesit nuk kanë vendosur bazë për diskriminim.<sup>13</sup>

<sup>12</sup> Një parashtresë mund të dorëzohet nga më shumë persona, shoqata dhe organizata qytetare, përkatësisht si diskriminues mund të vendosen më shumë persona.

<sup>13</sup> Në një parashtresë janë vendosur më tepër baza të diskriminimit.

Tabela 4: Numri i parashtresave të dorëzuara sipas bazave për vitin 2012



Në veprimtarinë për parashtresat e dorëzuara në bazë etnike si baza më e shpeshtë, nga 16 parashtresa gjithsej, KMD-ja ka vepruar për nëntë, kurse nuk ka vepruar për pesë. KMD-ja ka përcaktuar diskriminim vetëm në një parashtresë në bazë të përkatësisë etnike, kurse nuk ka përcaktuar diskriminim në tri parashtresa. Shumica e parashtresave, përkatësisht dhjetë janë dorëzuar nga romë. Numri i parashtresave nuk përputhet me gjendjen reale, ku romët janë të diskriminuar në një numër të madh rastesh dhe konsiderohen si bashkësia më e marginalizuar etnike. Në aspektin e fushave, në përputhje me KMD-në bashkësitë etnike janë diskriminuar më tepër në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës, sigurisë sociale, qasjes të mirat dhe shërbimet, arsimit, shkenca dhe sporti, informimi publik dhe mediat, si dhe fusha të tjera të përcaktuara me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.


Gjendja shëndetësore zë vendin e dytë si baza më e përfaqësuar në parashtresat e dorëzuara gjatë vitit 2012. Nga 12 parashtresa të dorëzuara, KMD-ja ka zgjedhur katër, për tri parashtresa ka përcaktuar se nuk ekziston diskriminim, kurse për një parashtresë nuk ka vepruar.

Përkatësia në grup të marginalizuar është baza e tretë sipas të cilës është dorëzuar numri më i madh i parashtresave në vitin 2012, përkatësisht 11. Nga parashtresat e dorëzuara KMD-ja ka zgjedhur vetëm dy, nuk ka përcaktuar diskriminim në një parashtresë, kurse nuk është ngritur procedurë për një parashtresë.

Në aspektin e fushave për të cilat dorëzuesit kanë shkruar se është kryer diskriminimi, fusha më e përmendur është fusha e punës dhe marrëdhënieve të punës me 28 parashtresa, kurse mandej vijojnë siguria sociale me 12 parashtresa, gjyqësori dhe institucionet me 10 parashtresa, arsimit, shkenca dhe sporti me gjashtë parashtresa,

qasja te të mirat dhe shërbimet me 11 parashtresa, informimi publik dhe mediat me tetë parashtresa, strehimi me një parashtresë, fusha të tjera me katër parashtresa dhe pa vendosje të fushës dy parashtresa.

Tabela 5: Parashtresa të dorëzuara sipas fushave përa vitin 2012



Edhe pse këtë vit ekziston trend në zmadhimin e parashtresave të dorëzuara në Komisioni, megjithatë shqetëson jashtëzakonisht e dhëna që Komisioni ka arritur të konstatojë diskriminim vetëm në një rast<sup>14</sup>. Komisioni edhe këtë vit e thekson buxhetin e vogël me të cilin e ka në dispozicion si një problem i madh në kryerjen e kompetencave dhe funksionimin normal në mungesë të Sekretariatit. Buxheti këtë vit ka qenë 4.665.000,00 denarë, prej të cilave janë shpenzuar 4.563.064,00. Edhe pse Komisioni në fund të vitit 2011 ka dorëzuar propozim-buxhet te Ministria e Financave, që i ka përmbajtur të gjitha nevojat reale, megjithatë ai nuk është miratuar. Për shembull, edhe pse kërkesa për buxhet për vitin 2012 për zërin e paraparë për ndërtim të kapaciteteve në zbatimin e LPMD-së është 50.000,00 denarë, nga Ministria e Financave janë miratuar vetëm 15.000 denarë, që me rebalancin e buxhetit janë zvogëluar në 10.000 denarë, prej të cilëve mund të shihet se nuk janë llogaritur mjetet e domosdoshme për zbatimin e aktiviteteve të Ligjit për zbatim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Si rrjedhim, nga Komisioni thonë se mungesa e mjeteve financiare është shkaku kryesor për prezencën e pamjaftueshme të anëtarëve të Komisionit në terren, midis qytetarëve, që, në çdo rast, është një nga prioritetet e këtij institucioni dhe që luan rol të rëndësishëm në qasjen e institucionit për mbrojtje të barazisë në të gjithë territorin e RM-së.

14 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2012.

## Praktika

Një vit pasi e ka dhënë mendimin me të cilin e ka gjykuar stigmatizimin e njerëzve në bazë të orientimit të tyre seksual (rast “Libri shkollor i Pedagogjisë”), Komisioni ka dhënë mendim të ri, këtë herë për rastin “Libri shkollor, Psikologjia kriminalistë”, ku gjeti arsytim shkencor për shfrytëzimin e përmbajtjeve shqetësuese ndaj personave transgjnorë dhe personave me orientim joheteroseksual. Midis të tjerash, libri i kontestuar e përmban këtë deklaratë stigmatizuese: “Dhuna e personave transvestitë ndaj seksit femëror mund të jetë shumë brutale, edhe pse e rrallë, si akt hakmarrjeje sepse natyra i ka dënuar duke mos u dhënë pamje tërësisht femërore”. Këto janë vetëm një pjesë e informacioneve të pasakta në këtë libër shkollor për të cilin Komisioni konsideron se “bahet fjalë për përshkrim shkencor të termit tranvestizëm, kurse termi devijim duhet të kuptohet në kontekstin e vet shkencor, ‘largim nga standardet e zakonshme apo të pranuar’”. Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi si dorëzues i parashtresës, menjëherë pas marrjes së mendimit e ka dënuar ashpër vendimin e Komisionit për arsyetimin shkencor të stigmatizimit eksplisit të njerëzve të cilët vishen me veshje të seksit të kundër si njerëz me devijime. Mandej, shqetësoi sidomos ndryshimi i drjetimit të qëndrimeve që i ka dhënë Komisioni, që assesi nuk çon drejt sigurisë juridike dhe mbrojtjes të përhershme nga diskriminimi i personave me identitet gjinor jobinar dhe orientim joheteroseksual. Paqëndrueshmëria dhe veprimi jo i njëjtë i Komisionit për lëndë të ndryshme me përmbajtje të ngjashme do të vazhdojë edhe në të ardhmen.<sup>15</sup>

## Veprimtaria e KMD-së në vitin 2013


Gjatë vitit 2013 në Komision janë dorëzuar 84 parashtresa gjithsej, prej të cilave për 44 raste Komisioni ka ngritur procedura. Nga numri i përgjithshëm i parashtresave, në 25 raste Komisioni ka ngritur procedurë dhe nuk ka konstatuar diskriminim, kurse në katër raste ka konstatuar diskriminim. Në dy raste Komisioni e ka ndaluar procedurën, sepse është bërë marrëveshje, kurse në 14 raste nuk ka vepruar, sepse kanë filluar procedurat gjyqësore ose nuk ka qenë kompetent të vendosë. Komisioni në vitin 2013 ka vendosur për 59 parashtresa, 19 prej të cilave janë dorëzuar në vitin 2012, kurse 40 janë dorëzuar në vitin 2013. Në lidhje me bazat, vazhdon trendi i paraqitjes së diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, për këtë flet edhe statistika në lidhje me bazat diskriminuese në parashtresat e dorëzuara. Numri i përgjithshëm i parashtresave në bazë të përkatësisë etnike është 21, në bazë të bindjes politike është 12, në bazë të statusit personal dhe social janë dorëzuar 12, në bazë të gjendjes shëndetësore janë dorëzuar tetë, në bazë të përkatësisë në grup të marginalizuar janë dorëzuar 9 parashtresa, në bazë të aftësive të kufizuara janë dorëzuar 6, në bazë të arsimit janë dorëzuar 7 parashtresa gjithsej, në bazë të prejardhjes sociale janë dorëzuar 6, në bazë të gjinisë janë dorëzuar 9 gjithsej, në bazë të fesë dhe bindjes

15 Raporti i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi nga viti 2011 deri në vitin 2013, mars 2014.

fetare janë dorëzuar 5, në bazë të moshës 4, në bazë të statusit familjar dhe martesor 2, në bazë të racës janë dorëzuar 3 parashtresa, në bazë të bindjeve të tjera 1 parashtresë, në bazë të ngjyrës së lëkurës janë dorëzuar 2 parashtresa, në bazë të gjuhës është dorëzuar 1, në bazë të shtetësisë është dorëzuar, gjithashtu, një parashtresë, në bazë të statusit të pronës janë dorëzuar dy parashtresa, në bazë tjetër janë dorëzuar 12 parashtresa, kurse në 12 parashtresa nuk është vendosur bazë.<sup>16</sup>

Në vitin e tretë e funksionimit të tij, sfidi kryesor i Komisionit vazhdoi të jetë mungesa e mjeteve financiare, që pengon realizimin e plotë të përgjegjësive të tij si rezultat i mungesës së fondeve për krijimin e një Sekretariati ose shërbimi administrativo-teknik profesional të Komisionit, i cili do të jetë përgjegjës për çështjet profesionale, administrative dhe teknike brenda fushëveprimit të Komisionit. Përkatësisht, buxheti për këtë vit ishte 4,557,000 denarë, nga të cilat janë shpenzuar 44,489,421 denarë. Edhe këtë vit, Komisioni dorëzoi projekt-buxhetin e tij në Ministrinë e Financave, i cili nuk u aprovua. Për të zvogëluar pasojat e këtij problemi dhe për të siguruar funksionimin e duhur të Komisionit, gjatë vitit 2013, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale siguroi një person përgjegjës për detyrat teknike dhe administrative dhe kështu ofroi mbështetje në funksionimin e punës së Komisionit.

Tabela 6: Numri i parashtresave të dorëzuara sipas bazave për vitin 2013




16 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2013.

Sipas raportit të Komisionit, megjithëse numri i parashtresave është rritur, ai ende nuk është një tregues i diskriminimit që po ndodh dhe është veçanërisht i ulët në këtë drejtim. Arsyet për këtë përfshijnë frikën e viktimizimit të dyfishtë, mungesën e besimit në institucione dhe mungesën e informacionit publik për ekzistencën e Komisionit si një organ për mbrojtje nga diskriminimi. E dukshme në punën e Komisionit në vitin 2013 është përfshirja aktive e organizatave të tjera në mbështetjen e punës së këtij organi përmes projekteve të ndryshme që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit publik, duke siguruar kështu një aktivitet më të madh të Komisionit përtej veprimtarisë për procedurat për parashtresat.

Sa i përket fushave ku janë dorëzuar parashtresat gjatë vitit 2013, fushat më të përhapura janë punë dhe marrëdhënie e punësimit me 36 parashtresa, sigurimi shoqëror me nëntë parashtresa, drejtësi dhe administratë me dhjetë parashtresa, arsim, shkencë dhe sport me dhjetë parashtresa, qasje në mallra dhe shërbime me nëntë parashtresa, informim publik dhe media me dy parashtresa, anëtarësim në sindikate, parti politike me dy parashtresa, kulturë me dy parashtresa, strehim me një parashtresa, fushë të tjera me gjashtë parashtresa dhe një parashtresë pa fushë të përcaktuar.

Tabela 7: Parashtresa të dorëzuara sipas fushave për vitin 2013



## Praktika

**Një rast në të cilin nuk u përcaktoi diskriminim është rasti i “Klinikës së Kirurgjisë Plastike dhe Rindërtuese”.** Ankuesi, HOPS, kërkoi që të përcaktohet diskriminim nga ana e klinikës në fjalë, pasi personeli mjekësor kishte mohuar në mënyrë të përsëritur të drejtën e trajtimit ndaj personave të diagnostikuar me varësi nga supstancat narkotike. Këta persona, pavarësisht se në cilën pjesë të ditës janë referuar në Klinikën (biles edhe kur kanë mbërritur herët në mëngjes), u lanë për të pritur për ekzaminim dhe ndërhyrje pas të gjithë pacientëve të tjerë, me arsyetim se për të mbrojtur pacientët e tjerë ata do të ishin të fundit që do t'i përdorin instrumentet. Gjatë ndërhyrjes, personeli mjekësor ndërmori masa për mbrojtje më të madhe (dy palë doreza, mbulesa speciale për mobiljet, etj.). HOPS i kërkoi KMD-së të përcaktojë diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të përpiqet të eliminojë stereotipet poshtëruese që kontribuojnë në poshtërimin dhe përjashtimin e grupeve të marginalizuara. HOPS paraqiti edhe deklarata nga dy persona që i nënshtroheshin një trajtimi diskriminues, të cilët përshkruanin se ishin pranuar për kontrollë mjekësore në një dhomë të ftohtë pa pajisje mjekësore, për të cilat ata thanë se ishte një depo të Klinikës së Kirurgjisë Plastike dhe Rindërtuese. Në zgjidhjen e këtij rasti, KMD mori numër të madh mendime-provash (një përgjigje nga Klinika e Kirurgjisë Plastike dhe Rindërtuese, Rregullorja për kriteret më të vërteta për parandalimin dhe shuarjen e infeksioneve intrahospitale) dhe Protokollin për parandalimin dhe shuarjen e infeksioneve intrahospitale, si dhe mendim të Odës së Mjekëve të RM-së). Gjatë procedurës, KMD gjithashtu filloi një takim me HOPS dhe kërkoi një mendim nga Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve, nga i cili nuk mori asnjë përgjigje. Kjo përprkëje e KMD-së për të mbledhur materiale gjithëpërfshirëse për këtë temë është një shembull pozitiv dhe duhet të jetë një praktikë e zakonshme e KMD-së. Në përgjigjen e saj, Klinika e Kirurgjisë Plastike dhe Rindërtuese shpjegon të gjitha aspektet e diskriminimit të pretenduar të përshkruar në ankesë. Si përmbledhje, Klinika pretendon se të gjithë pacientët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe trajtohen në përputhje me problemet e tyre shëndetësore. Duke vepruar kështu, Klinika kundërshton pretendimin se këta pacientë kanë mbetur të fundit, duke sqaruar se instrumente sterile përdoren për secilin pacient dhe se temperatura në të gjitha hapësirët e Klinikës është e njëjtë, sepse ka ngrohje qendrore. Është interesante që Oda e Mjekëve të RM-së, në përgjigjen e saj, konfirmon që pacientët me varësi nga supstancat narkotike janë trajtuar më në fund të ditës pune, pasi që sterilizimi i pajisjeve është një trajtim special dhe zgjat më shumë pas ndërhyrjeve të kryera mbi këto njerëz. Kjo përgjigje vetë e konfirmon trajtimin e pafavorshëm (duke pritur më gjatë) të pacientëve me varësi nga supstancave narkotike sesa pacientët e tjerë. Por, KMD-ja nuk gjeti ndonjë segment diskriminues në këtë rast, por u përpoq të ngushëllonte pacientët me paralajmërimin e reformës për caktimin elektronik dhe për recetët elektronike, zbatimi i të cilave do të lejojë ekzaminimet mjekësore në kohë. Vendime të tilla janë të papranueshme kur bëhet fjalë për trajtimin e pafavorshëm të personave në bazë të shëndetit të tyre, për shkak se Komisioni duhet të vendosë për ekzistimin e diskriminimit aty ku është kryer, pavarësisht nga mirëbesimi (reformat

e paralajmëruara, etj.) nga ana e diskriminuesve. Ky vendim paraqet vazhdim të mospërcaktimit të diskriminimit ndaj personave që vuajnë nga varësia e supstancave narkotike, nga Komisioni.

**Në të njëjtin vit, Komisioni konstatoi vetëm diskriminim të pjesshëm ndaj përdoruesve të substancave narkotike.** Ky rast u fillua pasi përdoruesit e shërbimeve të HOPS-it, që janë të varur nga substancave narkotike, raportuan se kishin kaluar kontrollë shtesë të hepatitit C para se të kishin ndërhyrja dentare dhe se këto ndërhyrje nënkuptonin kosto shtesë financiare. Gjithashtu, për shkak të rezultateve pozitive të testeve të hepatitit, ata u detyruan të paguanin pajisjet shtesë mbrojtëse të veshura nga stafi mjekësor. Procedura dhe kriteret të ndryshme financiare për përdorimin e të njëjtave shërbime dentare midis pacientëve të diagnostikuar me statusin e Hepatitit C, B dhe HIV dhe pacientëve të tjerë me sëmundje infektive dhe pacientëve që nuk kanë sëmundje infektive përbëjnë diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në statusin shëndetësor. Përveç aspektit financiar të diskriminimit, të varurit nga substancave narkotike që janë pozitivë për hepatitin C raportuan se janë dërguar në dhoma të ndara për shërbime dentare, ku vetëm ata morën trajtimet, dhe jo edhe ata që nuk kanë sëmundje infektive. Aparatet në këto ambiente të Klinikës Stomatologjike ishin në një gjendje shumë më të keqe sesa ato të pacientët e tjerë. Fatkeqësisht, Komisioni nuk gjeti diskriminim në trajtimin jo vetëm të pabarabartë ndaj personave të varur nga substancave narkotike, por edhe në trajtimin e tyre degradues për shkak të shëndetit të tyre, i cili më tej vuri në dyshim kompetencën dhe ndjeshmërinë e Komisionit për të vendosur për rastet e mundshme diskriminimi ndaj grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara, siç janë personat që përdorin substanca narkotike.<sup>17</sup>

**Në vitin 2013, fillon një prirje rritjeje në numrin e opinionëve pozitive të Komisionit që përcakton diskriminim në bazë të përkatësisë etnike dhe ngjyrës së lëkurës të personat me përkatësi etnike rome.** Dy raste indikative të kësaj tendence janë mendimi i favorshëm i Komisionit që përcakton diskriminim për shkak të përkatësisë etnike ndaj personave të përkatësisë etnike rome, të kryera nga punëdhënësi i tyre. Bëhet fjalë për një kompani që ofron shërbime higjienike në City Mall, e cila ka larguar të gjithë punonjësit romë që kanë punuar në zonat e shërbimit të ushqimit nën pretendimin e vjedhjes së ushqimit. Në këtë rast, Komisioni gjeti diskriminim të drejtpërdrejtë bazuar në përkatësinë etnike në fushën e marrëdhënieve të punës. Një rast tjetër në të cilin është vendosur diskriminim i drejtpërdrejtë bazuar në përkatësinë etnike të personave të përkatësisë etnike rome është rasti i pishinës “Snupi” në Veles. Përkatësisht, 20 persona me përkatësi etnike rome nga Shuto Orizari u përpoqën të hynin në pishinën “Snupi” në Veles, ku rojet e sigurisë ndaluan hyrjen me shpjegimin se pronari i pishinës nuk lejon hyrjen e romëve. Komisioni në këtë rast miratoi një mendim që përcakton diskriminim të

<sup>17</sup> Raporti i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi nga 2011 deri në 2013, mars 2014.



drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë etnike në qasjen në mallra dhe shërbime dhe u rekomandoi punonjësve dhe pronarit të pishinës që të eliminojnë shkeljen e të drejtës së personave të diskriminuar dhe në të ardhmen të mos veprojnë me paragjykime ndaj Romëve dhe t'u lejojnë qasje në pishinë, ashtu si lejojnë personat e tjerë.<sup>18</sup>


Është indikative që në tre vitet e para të themelimit të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi paraqiti gjithsej 25 ankesa, nga të cilat vetëm dhjetë ishin zgjidhur, dhe Komisioni u desh pothuajse pesë muaj mesatarisht që t'i zgjidh ato. Kjo do të ndikojë rreptësisht në ulje e besimit të Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi ndaj Komisionit, duke rezultuar në një ulje të numrit të parashtresave të dorëzuara në vitin 2014.

### Veprimtaria e KMD-së në vitin 2014

Gjatë vitit 2014, Komisioni pranoi gjithsej 106 parashtresa, me që vazhdoi prirja e rritjes së numrit të parashtresave të paraqitura çdo vit. Gjatë vitit 2014, gjithsej 80 raste janë përpunuar dhe plotësisht mbyllur, nga të cilat 30 janë transferuar nga viti 2013, ndërsa 50 janë hapur dhe përfunduar gjatë vitit 2014. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, në 34 raste Komisioni nuk ka konstatuar se ka diskriminim, ndërsa në pesë raste ka konstatuar se ka diskriminim të drejtpërdrejtë dhe në dy raste se ka pasur ngacmim. Nga 87 parashtresa të paraqitura nga individë, 52 janë parashtruar nga burra dhe 35 janë parashtruar nga gratë. Sa i përket bazave, përkatësia etnike përsëri dominon me gjithsej 26 parashtresa, 15 janë bazuar në statusin personal dhe shoqëror, 13 në bazë të grupit të marginalizuar dhe statusit shëndetësor, 8 në bazë të moshës, 13 në bazë të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike, 15 në statusin personal dhe shoqëror, 7 në përkatësinë politike, 8 në arsim, 3 në bindje të tjerë, 7 në bazë të fejes dhe bindjes fetare, në bazë të origjinës shoqërore janë 7, në bazë të shtetësisë janë 4 në bazë të gjuhës janë 2, në bazë të gjinisë janë 4, në bazë të ngjyrës së lëkurës janë 4, në bazë të racës janë 4 në bazë të seksit janë 10, me baza të tjera janë 14 parashtresa, ndërsa për 14 parashtresa bazat nuk janë të listuara.

Në vitin 2014, Komisioni prapë theksoi mungesën e mjeteve financiare si arsyen kryesore për praninë e pamjaftueshme të anëtarëve të Komisionit në terren dhe ndër qytetarët. Mungesa e burimeve të personelit është gjithashtu lidhur me financat, gjë që ndikon negativisht në të gjitha aktivitetet e Komisionit. Buxheti i miratuar për këtë vit ishte 4,505,865.00 denarë dhe ishte shpenzuar plotësisht. Të gjitha fondet përdoren për pagat dhe shërbimet komunale, dhe mungesa e financave, siç raporton edhe Komisioni, pasqyron mungesën e anëtarëve të Komisionit në terren.

Tabela 8: Numri i parashtresave sipas bazave për vitin 2014




Për sa i përket informimit, sipas raportit të Komisionit, një numër të madh aktivitetesh janë realizuar gjatë vitit 2014. Një pjesë e këtyre aktivitetëve u implementuan me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup në formën e organizimit të tetë punëtorive rajonale shtesë.

Për sa u përket fushave, në vitin 2014 shumica e parashtresave, si në vitet e kaluara, janë në fushën e marrëdhënieve të punës, pra gjithsej 42 parashtresa, 22 ishin në fushën e aksesit për mallra dhe shërbime, 18 në fushën e sigurimit shoqëror, 11 në fushën e sistemit gjyqësor dhe administratës, 7 në fushën e informimit publik dhe mediave, në 6 parashtresa baza nuk është listuar, 5 janë në arsim, shkencë dhe sport, 4 në fusha të tjera të përcaktuara me ligj, 2 janë në fushën e anëtarësimit dhe veprimin në kuadër të sindikatave, shoqatave politike dhe 2 në fushën e kulturës.

Në krahasim me të dhënat për vitin 2013, mund të konkludohet se numri i parashtresave është rritur në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës, por edhe në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime dhe sigurinë shoqërore, ndërsa në fushën e arsimit, shkencës dhe sporti ka rënie të numrit të parashtresave.

18 Raporti i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi nga 2011 deri në 2013, mars 2014.

Tabela 9: Parashtrësia të dorëzuara sipas fushave për vitin 2014



## Praktika

**Gjatë vitit 2014, RrMD-ja paraqiti 7 parashtrësia në KMD.** Komisioni nuk gjeti diskriminim në katër nga parashtrësit e paraqitura në vitin 2014, të cilat, mesatarisht, ishin zgjidhur brenda 2 deri në 11 muaj nga çështje. Nga ekzistimi i Komisionit deri në vitin 2014, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi ka pranuar vetëm një mendim në përputhje me afatin ligjor 90-ditor. Për mendime të tjera, Komisioni mesatarisht tejkalon afatin për 8 muaj për çdo parashtrësë. Komisioni filloi procedurat për 34 parashtrësia të parashtruara dhe përfunduara në vitin 2014. Nga 80 parashtrësia (të reja dhe të transferuara nga vitet e tjera) në 34 raste Komisioni nuk konstatoi se kishte diskriminim, në 5 raste konstatoi se kishte diskriminim të drejtpërdrejtë dhe në 2 raste që kishte ngacmim. Diskriminimi i konstatuar bazohet në pesë baza të ndryshme. Në dy raste, diskriminimi i vendosur bazohet në statusin personal ose social, në një rast në bazë të paaftësisë fizike, seksit, llojeve të tjera të bindjeve, moshës dhe përkatësisë në një grup të marginalizuar. Në dy raste, Komisioni konstatoi ngacmim, njëra prej të cilave bazohet në orientimin seksual në fushën e arsimit, dhe tjetra për arsye të përkatësisë politike në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës. Në 17 raste, Komisioni nuk ka vepruar në lidhje me parashtrësit për shkak të procedurës gjyqësore tashmë të nisur, mungesës së bazës për diskriminim ose sepse Komisioni nuk ka juridiksion të vepronte mbi to.

Për shkak të tejkalimit të dukshëm të afatit 90-ditor për përgjigje ndaj parashtrësive nga ana e Komisionit, i cili në rastin e segregimit të fëmijëve romë në procesin arsimor tejkaloi edhe tre vjet, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi vendosi të paraqesë një ankesë pranë Avokatit të Popullit kundër Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për trajtimin e parakohshëm të parashtrësive. Duke vepruar në përputhje me udhëzimet e Avokatit të Popullit për trajtimin e parashtrësive, Komisioni ia dorëzoi mendimet Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për dhjetë ankesa të paraqitura ndërmjet 2011 dhe 2013<sup>19</sup>.

**Një nga çështjet e zgjidhura pozitivisht që Komisioni miratoi në vitin 2014 është çështja kundër gazetarit Aleksandar Spasovski dhe kryeredaktorit të lajmeve të TV Sitel, Dragan Pavloviç-Llatas.** Ankesa u paraqit nga Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara" për një raport në lajmet qendrore të Televizionit Sitel në orën 19:00 në të cilin gazetari deklaroi se "homoseksualët kanë nevojë për ndihmë profesionale dhe mjekësore në vend të ndihmës juridike". Ankesa u ngrit gjithashtu kundër kryeredaktorit të lajmeve për lejimin e botimit të një artikulli që përmbante elemente të urrejtjes ndaj homoseksualëve që kishin për qëllim krijimin e frikës iracionale në publik.

Duke vepruar në bazë të parashtrësës së dorëzuar, Komisioni konstatoi se një raport i tillë përbente një akt diskriminimi, i cili përmbante elemente të gjuhës së urrejtjes, paragjykonte dhe shkelte dinjitetin e personave për shkak të orientimit seksual. Në mendimin e tij, Komisioni deklaroi se askush nuk ka të drejtë të ushtrorë (nën justifikim) të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila njëkohësisht inkurajon, sugjeron dhe drejton ngacmimin dhe mosrespektimin e individit dhe integritetin e çdo qytetari. Komisioni tregon dhe konsideron që personaliteti i personave LGBTI duhet të respektohet dhe duhet qenë të kujdesshëm kur komentjmë sjelljen e tyre, në mënyrë që të mos shqetësohen këta persona. Shprehjet e përdorura në këtë artikull mund të krijojnë një perceptim se njerëzit LGBTI nuk janë të mirë, ekziston një ndjenjë e keqkuptimit për ata dhe për ekzistencën e tyre, madje dhe urrejtje. KMD potencon se të gjithë janë të detyruar të përmbahen nga dallimet e pajustificuara ose trajtimi dhe nxitja e pabarabartë (përgjashtimi, kufizimi ose avantazhi) në lidhje me një person ose grup personash në bazë të statusit personal. Veçanërisht e rëndësishme është që Komisioni përcakton padukshmërinë e personave LGBTI në legjislacion, për shkak të mungesës së orientimit seksual si bazë për diskriminim. Prandaj, Komisioni rekomandoi që çdo palë në fushën e mediave të marrë përgjegjësinë për kufizimin e qëndrimeve dhe bërjen e dallimeve të pajustificuara ose trajtim dhe nxitje të pabarabartë, përgjashtim ose kufizim në lidhje me një person ose grup të personave mbi bazën e statusit personal. Komisioni gjithashtu kërkoi efektin prapaveprues të këtij detyrimi kur kjo është e mundur.<sup>20</sup>

<sup>19</sup> Raporti i punës së Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për periudhën 2011 deri në 2013.

<sup>20</sup> Njësoj si 10.

**I ngjashëm është rasti me Rrjetin për mbrojtje nga diskriminimi ndaj gazetës ditore “Veçer” dhe kryeredaktores Ivona Tallevska** për shkak se në katër botime të njëpasnjëshme të faqes së parë të gazetës u publikuan fotografi dhe “tituj spektakolarë” me përmbajtje diskriminuese ndaj njerëzve LGBTI. Veprime të tilla ishin një vazhdim i fushatës homofobike që kjo gazeta e kishte për një periudhë më të gjatë. Komisioni zbuloi se një fushatë e tillë ishte gjuhë urrejtjeje dhe shqetësim në mënyrë të përsëritur “mbi çfarëdo baze tjetër të parashikuar me ligj ose të ratifikuar nga një marrëveshje ndërkombëtare”, sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Sipas mendimit të tij, Komisioni kërkon një respektim më të madh të diversitetit në shoqërinë maqedonase, pavarësisht nëse ky diversitet është qartësisht përaktuar me ligj, ndërsa thekson rolin e rëndësishëm të gazetarëve dhe redaktuesve në krijimin e vetëdijes publike. Për më tepër, ata duhet të jenë në gjendje ta dallojnë diskriminimin, praktikat diskriminuese, si dhe të distancohen dhe të dënojnë çdo gjuhë të urrejtjes. Edhe pse opinioni është pozitiv dhe ka dënim për gjuhën e urrejtjes ndaj njerëzve LGBTI, KMD-ja nuk përcakton se aktet janë ngacim për shkak të orientimit seksual, por përkundrazi citon një pjesë të ligjit që thotë “çdo arsye tjetër të parashikuar me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare”. Duke vepruar kështu, Komisioni shkon një hap mbrapa dhe braktis praktikën e tij të tanishme të vendosjes së diskriminimit në bazë të orientimit seksual, që kontribuon për dukshmërinë e homoseksualëve dhe njohjen e diskriminimit që ata ndjejnë çdo ditë.<sup>21</sup>

**Gjithsesi, Komisioni nuk tregon qëndrueshmëri në vendosjen e diskriminimit ndaj personave LGBTI në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor kur është kryer nga figura publike në media. Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” i ka paraqitur një ankesë Komisionit për përcaktimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual kundër gazetës ditore “Veçer” dhe kryeredaktorit Dragan Pavloviç-Llatas.** Rasti ishte lidhur me një tekst diskriminues nga autori dhe pas parashtrësës u kërkoi që teksti të tërhiqej dhe që të fillohej procedurë kundërvajtëse ndaj shkelësve. Ankuesi argumentoi që autori i tekstit, i cili është edhe kryeredaktori i gazetës, përdor gjuhë të urrejtjes ndaj homoseksualëve, duke i stigmatizuar përmes deklaratave që kishin për qëllim të krijonin frikë joracionale publike ndaj homoseksualizmit. Kërkesa për të vendosur diskriminim, përveç dispozitave të ligjit, gjithashtu bazohej në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ka identifikuar diskriminim në raste të ngjashme. Sipas mendimit të tij, Komisioni konstatoi se nuk ka diskriminim, pasi që autori i tekstit nuk ka dhënë mendimin e tij, por ka ndarë informacione mbi zhvillimet me homoseksualët në rajonin dhe më gjerë. Menjëherë pas këtij përfundimi, Komisioni në mendimin e tij citon qëndrimin e autorit, dhe prapëseprapë e arsyeton me lirinë e shprehjes të garantuar me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Komisioni fare nuk analizon deklaratat e diskriminatorit të mundshëm të theksuar në parashtrësën, por përgjithësisht konkludon se autori nuk përhap, nxit,

21 Raporti i punës së Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për periudhën nga 2011 deri në 2013.

promovon ose justifikon urrejtjen ndaj homoseksualëve në tekstin. Në parashtrësën e mëparshme kundër të njëjtit autor, Komisioni shmanë veprimin dhe konstatimin e diskriminimit, me arsyetimin se teksti ishte botuar përpara se Ligji të hynte në fuqi.

**Një shembull tjetër i vendimmarrjes jokonzistente nga Komisioni në rastet e diskriminimit ndaj njerëzve LGBTI, veçanërisht kur si diskriminues të mundshëm paraqitet ndonjë person publik apo politikan është rasti i ish-Ministrit të punës dhe politikës sociale – Spiro Ristovski.** Në janar 2013, disa organizata nga Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi paraqitën një parashtrësë për Komisionin të vendosë diskriminimin për shkak të orientimit seksual, të statutit familjar dhe martesor dhe të rekomandojnë që Ministri i atëhershëm i punës dhe politikës sociale, Spiro Ristovski, t'i tërheqë ato deklaratat diskriminuese të bëra në media. Ankuesit argumentuan se në një deklaratë për mediat, Spiro Ristovski bëri dallimin midis gjendjes shëndetësore të heteroseksualëve dhe homoseksualëve, si dhe midis fëmijëve të rritur në bashkësi me prindër heteroseksualë, homoseksualë, me vetëm një prind ose pa prindër. Familjet heteroseksuale me dy prindër, nënë dhe baba, Ministri i definoi si një mjedis të shëndetshëm dhe natyror, duke përjashtuar në këtë mënyrë nga kombi i shëndetshëm personat dhe komunitetet homoseksualë, si dhe të gjitha komunitetet e tjera që kanë fëmijë jashtë “formës së vërtetë biologjike”. Me këtë deklaratë, ai diskriminon të gjithë fëmijët e rritur nga nënat beqare, fëmijët e rritur nga të afërmit, fëmijët pa prindër, fëmijët e birësuar, fëmijët e rritur nga çiftet të të njëjtit seks, fëmijë nga kultura të ndryshme në të cilat parimi i martesës dhe çifti biologjik nuk është thelbësor në procesin e rritjes dhe kujdesit për fëmijët. Sipas mendimit të Komisionit, në fjalimin e Spiro Ristovskit nuk ka nxitje të urrejtjes ose përmbajtje shqetësuese për cilindo nga arsyet e përfshira në nenin 3 të Ligjit dhe vendosi që nuk kishte diskriminim. Në mendimin e Komisionit, fjalët e diskriminuesit të mundshëm nuk janë analizuar fare, jepet vetëm një mendim të përgjithshëm me të cilën arsyetohet deklaratën e përmes lirisë së shprehjes. Vendimi i Komisionit nuk është i vërtetuar me argument juridik, dhe nuk është lidhur me ndonjë ligj ose ndonjë marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, që lë përshtypjen se është një mendim personal i anëtarëve të Komisionit, dhe jo një mendim i bazuar në ligj. Nga ky këndvështrim është e qartë se Komisioni nuk arriti të sigurojë pavarësinë në vendimmarrje, duke marrë parasysh që vendimi është marrë në një kohë kur Spiro Ristovski ishte akoma Ministri aktual i punës dhe politikës sociale, dhe kryetari i KPD-së dhe një anëtar tjetër i ish-institucionit në Ministrinë për punën dhe politikën sociale.<sup>22</sup>

**Një rast i ngjashëm që reflekton mungesën e pavarësisë në vendimmarrjen e Komisionit është rasti i një fushate diskriminuese qeveritare kundër abortit.** Parashtrësja për Fushatën kundër abortit, e paraqitur nga Shoqata e Qytetarëve HERA kundër Qeverisë dhe Këshillit për Radiodifuzion, tani Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale, është një rast në të cilin Komisioni nuk gjeti shqetësim.

22 Raporti i punës së Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për periudhën nga 2011 deri në 2013.



Sipas Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi, Qeveria e ka porositur dhe prodhuar, ndërsa Këshilli për Radiodifuzion lejoi transmetimin e një reklame kundër abortit me përmbajtje shqetësuese dhe të pakëndshme, e cila stigmatizon dhe shkel dinjitetin njerëzor të grave që kërkojnë abort dhe krijon mjedis poshtërues dhe të frikshëm për punonjësit e shëndetësisë për të kryer abortin. Në reklamën, e drejta e garantuar me kushtetutë për abort është barazuar me krimin e vrasjes. Pas një parashtresë nga një grup deputetësh, Këshilli për Radiodifuzion vendosi ta kategorizojë videon si një program të kategorisë së pestë dhe ta transmetojë vetëm mes orës 00:00 - 05:00. Pas këtij vendimi, videoja vazhdoi të transmetohej në transmetuesin e shërbimit publik dhe në disa stacione televizive private, jashtë orarit kur u transmetuan programet televizive të kategorisë së pestë, në një formë të modifikuar, pra pjesa në të cilën aborti u identifikua si vrasje është censuruar, dhe imazhi shfaqet nën titullin “Censuruar nga Këshilli për Radiodifuzion të Republikës së Maqedonisë”. Në fund të videos, ka një citim nga Nënë Tereza me përmbajtjen e mëposhtme: “Është mekat që fëmija të mos jetojë vetëm që ju të mund të jetoni si të dëshironi”, duke rikthyer kështu konotacionin shqetësues që aborti është vrasje.

Për shkak të gjithë kësaj, HERA paraqiti një parashtresë pranë Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale (ish-Këshilli për Radiodifuzion) duke kërkuar tërheqjen e videos, për të cilën u mor një përgjigje negative. Pas një epilogu të tillë dhe një vendimi negativ nga Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale, një parashtresë për shqetësim u dërgua në Komisionin. Është shqetësuese që sipas mendimit të tij Komisioni nuk hyn në vlerësimin e videos dhe nuk jep mendimin e vet për ekzistencën e ngacmimeve të mundshme, por i referohet procedurës së kryer më parë për të njëjtën video përpara Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale (ish-Këshilli për Radiodifuzion). Kjo bën përshtypjen se Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale (ish-Këshilli për Radiodifuzion) ka më shumë ekspertizë, profesionalitet dhe legjitimitet për të vendosur për çështje të drejtave të njeriut sesa Komisioni, i cili është (duhet të jetë) një organ ekspert për mbrojtjen e të drejtave të barazisë, mbrojtja kundër diskriminimit dhe ngacmimit. Është jologjike dhe konfuzë se si Komisioni sipas mendimit të vet e deklaroi veten të paaftë për të vepruar në lidhje me ankesat e ngacmimit, megjithëse Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi përcakton në mënyrë të qartë që Komisioni po vepron në lidhje me ankesat e diskriminimit dhe ngacmimit. Megjithëse shpallet pakompetent për të vepruar në lidhje me ankesën, Komisioni megjithatë rekomandon në mendimin e vet që ankuesit të kërkojnë drejtësinë para autoriteteve të tjera kompetente, pa specifikuar se kush janë ato organe.<sup>23</sup>

23 Raporti i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2014.

#### Një rast indikativ është rasti i segregimit të fëmijëve romë në procesin arsimor<sup>24</sup>.

Komiteti i Helsinkit ia paraqiti çështjen Komisionit në prill 2011 dhe mori një përgjigje në dhjetor 2014, pas tre vjet dhe pesë muaj. Koha për të vendosur për këtë rast është rekord në tejkalimin e afatit kohor për veprimin e Komisionit ndaj parashtresave të paraqitura nga anëtarët e Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi. Ankesa u ngrit kundër pesë shkollave fillore në Manastir për ndarje të raportuar kundër fëmijëve të përkatësisë etnike romë në përpjekje për t'u regjistruar në shkollën fillore. Ankuesit e këtyre rasteve thanë se fëmijëve nga komuniteti etnik rom u ishte refuzuar hyrja në shkollë fillore në zonën e tyre të banimit dhe u dërguan në shkollën fillore “Gjorgji Sugarev”, ku shumica e nxënësve ishin romë, duke thënë se nuk kishte vend për ata në shkollat në të cilat ata kanë aplikuar fillimisht. Edhe në këtë rast, Komisioni nuk vendosi diskriminim, duke përmendur përgjigje dhe takime me zyrtarët e shkollës fillore se nuk kishte diskriminim ndaj fëmijëve romë, si dhe një raport nga Drejtoria për zhvillimin dhe promovimin e arsimit në gjuhët e komuniteteve ku, sipas Komisionit, u deklarua se prirja është e kundërt, dmth që prindërit romë regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollën fillore “Gjorgji Sugarev”. Në bazë të kësaj, Komisioni konstaton se ekziston një i ashtuquajtur “ndarje natyrore”, megjithëse deklaroi se nuk pajtohet me këtë term, d.m.th që ekziston një tendencë që prindërit të regjistrojnë fëmijët romë në këtë shkollë, edhe pse kjo shkollë është jashtë rajonit ku ata jetojnë, e cila është në përputhje me Ligjin për arsimin fillor. Komisioni nuk e shpjegon fare raportin e paraqitur nga drejtori i Drejtorisë për zhvillimin dhe përmirësimin e arsimit në gjuhët e komuniteteve ku u gjet ky problem, as nuk merr parasysh deklaratën nga drejtori i shkollës fillore “Gjorgji Sugarev” e bërë gjatë inspektit të shkollës, ku thotë seshumica e prindërve të kombësisë maqedonase i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollën fillore “Todor Angelevski” sepse nuk duan që fëmijët e tyre të mësojnë me fëmijët romë. Shkolla e përmendur regjistron nxënës që nuk i përkasin rrethit të tij. Në të njëjtën kohë, për një periudhë prej tre vjet dhe pesë muaj, për sa kohë që Komisionit u desh të jepte një mendim për këtë rast, pritej që të ofrohet ndonjë shpjegim se pse nuk është vërtetuar ekzistenca e segregimit. Përkundër pritjeve të tilla, Komisioni ka lëshuar një mendim që përmban regjistrimin faktik të korrespondencës që ka marrë nga institucionet kompetente, pa analizuar përmbajtjen e dokumenteve të tilla, mbi bazën e të cilave duhet ofruar një shpjegim adekuat për mosidentifikimit të ekzistencës së segregimit të fëmijëve romë.

#### Në vitin 2014, Komisioni miratoi gjithashtu disa mendime në lidhje me përmbajtjen

**diskriminuese të disa teksteve shkollore** - “Psikologjia mjekësore”, “Psikiatria” - vëllimi 1 dhe “Psikiatria” - vëllimi 2. Këto tekste shkollore përdoren në arsimin e lartë në Sh. “Kirili dhe Metodi” si një literaturë profesionale psikologjik-psikiatrike për mjekësi, psikologji dhe studime të ngjashme. Tekstet shkollore përmbajnë përmbajtjet homofobike që paraqesin homoseksualitetin si një çrregullim mendor, një përmbysje të lëvizjes seksuale, definojnë “aktivitetin normal seksual” si aktivitetin seksual të

24 Raporti vjetor i Komitetit të Helsinkit për vitin 2015.



personave të gjinive të ndryshme, etj. Komisioni riafirmoi shpjegimin e dhënë në parashtrësën se kur bëhet fjalë për orientimin seksual, mendimi modern shkencor njihet homoseksualitetin, heteroseksualitetin dhe biseksualitetin (ndërsa disa punime shkencore përmendin edhe aseksualitetin). Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore i Organizatës botërore të shëndetit (KSS - rishikimi 10), si dhe Doracaku diagnostikues dhe statistikor i çrregullimeve mendore (DSD IV-TR) si burimet më të rëndësishme, e kanë lënë mënjanë orientimin seksual nga lista e çrregullimeve mendore qysh në vitin 1987, me që në KSS - rishikimi 10 thotë se “Orientimi seksual vetë nuk duhet të konsiderohet një çrregullim.” Komisioni rekomandoi që seksionet e librave shkollorë të hiqen dhe të hidhen jashtë përdorimit, ndërsa në shpjegimin e vet, Komisioni deklaroi se shumica e autorëve të teksteve shkollore kërkuan falje për gabimet në tekstet. Sidoqoftë, kjo pozitë e KMD nuk u vërtetua në mendimin e dhënë në rastin e “Teksteve shkollore me përmbajtje diskriminuese në psikologji dhe studime gjinore në Fakultetin e Filozofisë në UKIM”, ku Komisioni argumentoi se nuk kishte diskriminim me arsyetimin se pluralizmi i qëndrimeve shkencore dhe argumentimi janë karakteristik për bashkësinë akademike dhe e trajton librin shkollor në fjalë si pjesë të atij pluralizmi.<sup>25</sup>

### Veprimtaria e KMD-së në vitin 2015


Gjatë vitit 2015, Komisioni pranoi gjithsej 70 ankesa, një ulje e ndjeshme në krahasim me vitin 2014. Komisioni e sheh arsyen e kësaj prirjeje si mungesa e një shërbimi administrativ (sekretariati), i cili do të forconte kapacitetet dhe do të lehtësonte punën e Komisionit. Në raportin e tij, Komisioni vëren se gjithashtu ka hasur probleme me mungesën e financave për funksionim të mirë si vitet e kaluara, dhe veçanërisht me mungesën e një departamenti financiar, mungesën e profesionistëve për menaxhim efikas dhe përditësimin e faqes së saj të internetit dhe të programit ekzistues të të dhënave, si dhe problemet me dërgimin dhe pranimin e postës në kohë dhe me efikasitet. Gjatë vitit 2015, Komisioni përpunoi dhe mbylli gjithsej 66 raste, 35 prej të cilave janë transferuar nga vitet e kaluara, dhe 35 janë hapur dhe përfunduar gjatë 2015. Komisioni nuk konstatoi se kishte diskriminim në 15 raste të procesuara, ndërsa në tre raste konstatoi se kishte diskriminim të drejtpërdrejtë. Në 12 raste, Komisioni nuk ka vepruar në lidhje me parashtrësat për shkak të një padie tashmë në proces, mungesës së bazave për diskriminim ose sepse Komisioni nuk kishte juridiksion për të vepruar mbi to.

Për sa u përket bazave, është vërejtur një rritje e dukshme e numrit të parashtrësive në krahasim me vitet e kaluara, dhe veçanërisht në rastet që përfshijnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar, parashtrësive ku nuk përmenden baza dhe parashtrësive e paraqitura nën ndonjë bazë tjetër. Vlen të përmendet që Komisioni vazhdon të

mos i regjistrojë dhe të mos i numërojë parashtrësive të diskriminimit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si një kategori e veçantë dhe të regjistrojë ato në kategorinë “baza të tjera”. Gjatë vitit 2015, numri më i madh i parashtrësive u parashtrua pa përcaktuar baza, d.m.th gjithsej 17, dhe numri i dytë më i lartë i parashtrësive, d.m.th. 14, janë në kategorinë baza të tjera. Përkatësia etnike ra këtë vit në numrin e parashtrësive dhe nëntë parashtrësive u ngritën mbi këtë bazë. Tetë parashtrësive janë parashtruar në bazë të statusit personal ose shoqëror, i njëjti numër është paraqitur në bazë të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike, tetë parashtrësive janë ngritur në bazë të moshës, dhe tetë janë ngritur në bazë të gjendjes shëndetësore. Për më tepër, pesë parashtrësive u ngritën mbi bazën e përkatësisë politike, katër për origjinë sociale, katër në bazë të familjes ose statusit martesor, në bazë të gjuhës janë tre, në bazë të arsimit tre, në bazë të seksit dy, në bazë të shtetësisë janë dy parashtrësive, në bazë të fesë ose të besimit fetar janë dy, në bazë të bindje të tjera janë dy parashtrësive, në bazë të statusit i pronarisë janë dy, në bazë të ngjyrës së lëkurës është një, në bazë të gjinisë është një parashtrësive, dhe në bazë të përkatësisë në ndonjë grup të marginalizuar është një parashtrësive.


25 Raporti i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2014.

Tabela 10: Numri i parashtrësive sipas bazave për vitin 2015



Në lidhje me fushat, gjatë vitit 2015 shumica e parashtrësive prapë janë në fushën e punës dhe marrëdhëniet pune, domethënë gjithsej 30 parashtrësive, fusha e dytë është siguria sociale me 14 parashtrësive. Për 13 parashtrësive fusha nuk është shënuar, nga 4 parashtrësive ka në fushat e gjyqësorisë dhe institucioneve, strehimit dhe qasjes në mallra dhe shërbime, ndërsa nga tri parashtrësive në fushat e arsimit, shkencës dhe sportit, informimit publik dhe mediave dhe të fushave të tjera të përcaktuara me ligj.

Tabela 11: Parashtrësive të dorëzuara sipas fushave për vitin 2015



Në 58 prej parashtrësive është shënuar vetëm nga një bazë diskriminimi, ndërsa te 12 parashtrësive është shënuar diskriminim të shumëfishtë, domethënë dy ose më shumë baza diskriminimi.

Edhe këtë vit Komisioni përballlet me buxhet të vogël dhe të pamjaftueshëm për realizim të të gjitha ingjierencave dhe funksionim të plotë. Buxheti i miratuar është 4.557.000 denarë, prej të cilave u shpenzuan 4.448.204 denarë, të gjithë janë shpenzuar për rrogat, shërbime komunale dhe mirëmbajtje.

### Praktika

**Në vitin 2015, për herë të parë te Komisioni është paraqitur parashtrësive për një rast diskriminimi, për të cilin fillimisht u bë testimi i situatës.** Domethënë, bëhet fjalë për mungesë të qasjes në kopshtet për fëmijët me përkufizim intelektual. Në rastin konkret, bëhet fjalë për një fëmijë hiperaktiv me përkufizim të lehtë intelektual dhe pengesa në të folurit. Sipas mendimit të Entit të shëndetit mendor – Shkup, fëmija duhet të kyçet në trajtim me defektolog dhe logoped dhe të kyçet në grup të moshës parashkollore. Për një periudhë, fëmija ka qenë kyçur në kopshtin, por për shkak të presioneve nga nëpunësit e kopshtit, poashtu për shkak të kujdesit të papërshtatshëm dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore për punë me fëmijë me pengesa intelektuale, prindërit u detyruan ta çregjistrojnë nga kopshti dhe të gjejnë ndonjë kopsht tjetër (publik ose privat) që ka kapacitete vendore dhe njerëzore për kujdes të fëmijëve me pengesa të lehta intelektuale. Prej këtij momenti, prindërit kanë ndërmarrë një numër përpjekjesh për ta kyçur fëmijën në ndonjë kopsht publik ose privat, por të gjitha përpjekjet ishin pa sukses. Kjo është mungesa e sistemit në përgjithësi që posaçërisht reflektohet mbi fëmijët me pengesa intelektuale dhe e kufizon, ose mund ta kufizojë, të drejtën e qasjes në kopshtet. Problemi rrjedh prej fakti që në Nenin 64 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve është parashikuar se në grupet e rregullta mund të kyçet vetëm një fëmijë me fëmijë me pengesa të lehta në zhvillimin mendor ose me kufizim trupor, dhe në atë rast, numri i lejuar të fëmijëve të tjerë ulet për dy fëmijë. Për më tepër, ky rregull rrallë po respektohet, për shkak se në shumicën e kopshteve, posaçërisht kopshtet në komunat e Qytetit të Shkupit, përfshijnë numër më të madh fëmijësh sesa standardet e parashikuara, me qëllim që sa më shumë fëmijë të jenë kyçur në procesin edukues të kopshteve. Kështu mund të përmbledhim se kapacitetet e dobëta njerëzore dhe vendet e kufizuara brenda kopshteve ndikojnë mbi qasjen e fëmijëve me kufizime mendore, të cilët kanë nevojë të ndryshme sesa fëmijët pa pengesa në zhvillim. Për shkak të asaj, Komiteti i Helsinkit gjatë dy viteve të fundit posaçërisht punoi mbi qasjen në kopsht për fëmijët me pengesa intelektuale. Komiteti ka zbatuar testim të situatës përmes thirrjeve telefonike me qëllim që ta hulumtojë diskriminimin e mundshëm nga ana e kopshteve ndaj fëmijëve me pengesa intelektuale. Njëri prej qëllimeve ishte të përcaktohet nëse kapacitetet e dobëta njerëzore dhe të vendeve të disponueshme ndikojnë mbi qasjen në kopsht për fëmijët me pengesa intelektuale. U testuan gjithsej 70 kopshte nga gjithë vendi, prej të cilave 56 ishin kopshte publike/

shtetërore dhe 14 kopshte private. Në bazë të të dhënave të grumbulluara mund të konstatohet se nuk ekzistojnë as kapacitete njerëzore as vende të mjaftueshme në kopshtet për strehim dhe edukim të të gjithë fëmijëve të moshës parashkollore të cilët kanë nevojë për regjistrim në kopsht. Plotësisht, me këtë hulumtim u përcaktuan edhe disa raste ku ekziston dyshim për diskriminim të drejtëpërdrejtë ndaj fëmijëve me pengesa të lehta intelektuale, dhe për shkak të asaj, Komiteti i Helsinkit dorëzoi një parashtrësë te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi. Fatkeqësisht, Komisioni vendosi se në rastin konkret nuk ka diskriminim.<sup>26</sup>

Në vitin 2015, te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi u drejtua një person i cili tregon se është diskriminuar në bazë të ngjyrës së lekurës dhe të përkatësisë etnike, në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime, nga ana e personave të punësuar në Ministrinë e punëve të brendshme, kalimi kufitar Aeroporti “Aleksandër i Madh”, Shkup. Ankuesi shpjegon se së bashku me të dashurën e tij dhe dy studentë të tjerë ishin ndaluar që ta mos kalojnë kufirin brenda aeroportit “Aleksandër i Madh”, Shkup, vetëm për shkak të pamjes se tyre fizike, për shkak të ngjyrës së lekurës, domethënë ishin të diskriminuar. Ankuesi shpjegon se pasi i kishin regjistruar bagazhin me procedurë të rregullt, u drejtuan kah kalimi kufitar ky polici përgjegjës i ka pyetur ku do të udhëtojnë dhe ankuesi i ka shpjeguar se do ta vizitojë dajën dhe ka dorëzuar provën për udhëtimin, biletë kthimi, sigurim udhëtimi nga kompania sigurimi “Sava” dhe para – 900 euro. Gjithsesi, polic përgjegjës ka thënë se ankuesi dhe e dashura e tij nuk do të udhëtojnë dhe të mospolemizojnë më. Pastaj, e dashura e ankuesit e ka pyetur policinë nëse arsyeja është ngjyra e lekurës së tyre, kur një polic tjetër u shoqëruar në bisedën me fjalët “Shikoni, zonjushën, nga pikëpamja statistikore, Romët më shumë kërkojnë azil në vendet evropiane”. Për konstatim të saktë të gjendjes faktike, Komisioni, brenda afatit kohor, e ka dorëzuar parashtrësën deri te personi kundër të cilit është ngritur parashtrësja, që edhe ai të jep sqarime në lidhje me pohimet në parashtrësën, i ka shqyrtuar provat e dorëzuara nga ana e ankuesit, por ka kryer shqyrtim edhe në përgjigjen e diskriminatorit të mundshëm. Duke i marrë parasysh të gjitha faktet, Komisioni ka vendosur se mbi ankuesin është kryer diskriminim në bazë të ngjyrës së lekurës dhe përkatësisë etnike, në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime, nga ana e personave të punësuar në Ministrinë e punëve të brendshme, kalimi kufitar aeroporti “Aleksandër i Madh”, Shkup. Ky është një prej rasteve të shumta përkufizimi të të drejtës së lëvizjes së lirë dhe të kalimit të kufijve që është bërë ndaj personave të përkatësisë rome, dhe sinjalizon për një problem sistematik. Edhe pse Komisioni në këtë rast ka përcaktuar se bëhet fjalë për diskriminim të drejtëpërdrejtë, fatkeqësisht, në mendimin e tyre ata japin vetëm rekomandim të gjerë dhe të përgjithshëm për Ministrinë e punëve të

26 Raporti vjetor i Komitetit të Helsinkit për vitin 2015.

brendshme t'i ndërmarrë të gjitha masat që të mos përsëritet ndongjë rast të këtillë të padëshirueshëm, pa dhënë propozim-zgjidhje dhe masa më konkrete për parandalim të diskriminimit të këtillë sistematik.<sup>27</sup>

## Veprimtaria e KMD-së në vitin 2016

Në vitin 2016 mandati i anëtarëve të Komisionit të cilët ishin përzgjedhur në përbërjen e parë të Komisionit mbaroi, dhe në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi u zgjedhën anëtarë dhe kryetar të Komisionit. Zgjedhja e përbërjes së re të Komisionit ishte tepër kritikuar nga ana e Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi,<sup>28</sup> sepse, edhe pse kishte nevojë për ndryshim thelbesor në përbërjen e Komisionit dhe përfshirje të ekspertëve me eksperiencë nga fusha e mosdiskriminimit, Kuvendi vendosi ta zgjedhë anëtarë, shumica prej të cilëve nuk kanë përvojë nga fusha as kanë punuar me grupe të cënueshme. Përveç mungesës së përvojës në fushën e mosdiskriminimit, shumica e anëtarëve ishin kritikuar nga publiku për shkak të lidhjen e tyre me koalicionin që në atë kohë ishte në pushtet. Kështu, njëri prej anëtarëve, Aleksandër Spasenovski, ka qenë deputet i VMRO-DPMNE në Kuvendin e RM-së në periudhën nga 2006 deri në 2014, ndërsa Irfan Dehari ka qenë deputet i BDI-së në periudhën 2011-2014. Gjithashtu, dy prej anëtarëve të sapozgjedhur, Toni Naunovski dhe Aleksandër Dashtevski, ishin përkrahës të hapur të politikave të pushtetit, posaçërisht të politikave që nuk mundësojnë trajtim të barabartë për pakicat etnike në shtetin. Me këtë përbërje të Komisionit, nuk u plotësuan as standardet minimale për pavarësi dhe nuk u mori parasysh diverzitetin dhe përfaqësimin e komuniteteve të marginalizuara.

Në raportin e vet, Komisioni përsëri thekson se është hasur me probleme dhe pengesa të shumta për shkak të mosekzistimit të një departamenti për financa pranë Komisionit, mungesa të personave përgjegjës për menaxhim dhe përditësim të faqes së internetit të Komisionit, si dhe probleme me dërgim dhe pranim të postës në mënyrë efikase dhe me kohë. Për këtë vit, buxheti i miratuar ka qenë 5.032.000,00 denarë, prej të cilave, sipas planit kumulativ, u miratuan 4.497.000,00 denarë, dhe prej tyre u realizuan 4.478,889,00 denarë, ndërsa 18.111,00 denarë kanë mbetur. Në vitin 2016, gjithsej 277.977,00 denarë kanë mbetur të pashlyera.


Gjatë vitit 2016, deri te Komisioni u dorëzuan gjithsej 60 parashtrësja, ndërsa janë lëshuar gjithsej 80 medime, prej të cilave në 7 raste është vendosur se ka diskriminim dhe diskriminatorëve u dhanë rekomandime, kurse në 31 raste është vendosur se nuk ka diskriminim. Mund të vërejmë se numri i parashtrësive vazhdon të ulet, tani ka 10 parashtrësja më pak se vitin e kaluar. Komisioni nuk ka marrë vendim për 20

27 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2015.

28 RMD: Përbërja jokompetente e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, <https://www.radiomof.mk/mzd-nekompetenten-sos-tav-na-komisijata-za-zashhita-od-diskriminacija>

parashtresa për shkak të moskompetencës së tyre për të vepruar në këto raste, ndërsa në 2 raste e ka ndërprerë procedurën. Komisioni nuk ka vepruar në lidhje me 20 parashtresa për shkak se nuk kanë arritur qëllimin e parashtresës. Në aspektin e bazave, më shumë parashtresa janë dorëzuar për shkak të diskriminimit në bazë të statusit personal dhe shoqëror, gjithsej 18%, pastaj vijnë përkatësia etnike me 17%, përkatësia politike 15%, seksi 13%, gjendja shëndetësore 12%, dhe bindje të tjera 10%<sup>29</sup>. Si praktikë pozitive, Komisioni e përmend faktin se shumica e diskriminatorëve të mundshëm, pas rekomandimit nga Komisioni kanë treguar gatishmëri për ta hequr lëndimin e të drejtës, por njëkohërisht ekzistojnë edhe ata që i ijorojnë rekomandimet e Komisionit. Nga parashtresat e dorëzuara mund të shihet se diskriminimi nga individë më shpesh është kryer me vetëdije, ky me deklaratë apo sjellje të caktuara shkelet dinjiteti i një personi apo grup personash për shkak të karakteristikave të tyre personale. Shpesh, sjellja e tillë është e motivuar nga urrejtja për grupe të caktuara të marginalizuara.<sup>30</sup>

Tabela 12: Numri i parashtresave sipas bazave për vitin 2016




Në lidhje me fushat, puna dhe marrëdhënie pune mbetet fushë më të përhapur me numër më të madh të parashtresave dhe 40% prej numrit të përgjithshëm. Parashtresat për shkak të diskriminimit në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime përbëjnë 25%, mediat dhe informimi publik janë 13% dhe 8% janë në fushat e gjyqësorisë, institucioneve dhe arsimit, shkencë dhe sport, 6% në fusha të tjera. Ky është raporti

29 \*Në raportin vjetor të KMD-së mungojnë të dhënat për bazat e tjera.

30 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2016.

i parë i Komisionit ku të dhënat janë shfaqur vetëm me përqindje në lidhje me bazat dhe fushat të diskriminimit, që vështirëson përcaktimin e numrit të parashtresave të dorëzuara sipas bazave dhe fushave të ndryshme.

Tabela 13: Parashtresa të dorëzuara sipas fushave për vitin 2016



### Praktika

**Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi në qershor 2016 mori vendimin me të cilin përcaktoi diskriminim të drejtëpërdrejtë në bazë të identitetit gjinor për shkak të refuzimit të hyrjes në objekt që ofron shërbime publike – pishinë, domethënë qasje të kufizuar në shërbimet për shkak të identitetit të tij gjinor.** Duke vepruar në bazë të parashtresës për diskriminim në bazë të identitetit gjinor, të dërguar nga ana e Komitetit të Helsinkit, Komisioni ka vendosur se ka diskriminim ndaj personit transgjinor në qasjen e tij në mallra dhe shërbime. Personit transgjinor i ishte refuzuar e drejta hyrjeje në pishinë, me që është bërë diskriminim. Në mendimin e lëshuar, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka përcaktuar diskriminim në bazë të gjinisë, që është mendim i parë në të cilën Komisioni, në mënyrë më detale, interpreton gjininë si karakteristikë të mbrojtur dhe e zbaton edhe gjatë mbrojtjes nga diskriminimi ndaj personave transgjinorë. Plotësisht, Komisioni i ka rekomanduar diskriminuesit që të kompensojë për dëmin e kryer brenda afatit prej 30 ditësh, sepse në rastin e kundërt Komisioni do të veprojë sipas nenit 29 të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, domethënë do të nisë iniciativë përpara organeve kompetente për përcaktim të përgjegjësive të kryesit. Pas marrjes së mendimit dhe gjatë këshillimit me Komitetin e Helsinkit, viktimi si palë të dëmtuar, dhe diskriminuesi si shkaktes të dëmit, u pajtuan jashtë gjykatës për zgjidhjen e mosmarrveshjes. Për këtë qëllim, ata morën vesh për kompenzim të dëmit, ku diskriminuesi pranoi fajin e vet për ngjarjen dhe të dyja palët ranë dakort



për shumën e kompensimit financiar, si dhe për kushtet të pagesës<sup>31</sup>. Nga përvoja e deritanishme të anëtarëve të Rrjetit për mbrojtje nga diskriminim në testimin e punës së Komisionit, kjo është hera e parë që Komisioni të përcaktojë kompensim financiar për dëmin e bërë dhe ta paralajmëroj kryesin për mundësinë që Komisioni mund të nisë iniciativë përpara organet përkatëse. Me rekomandimin e këtillë, Komisioni bëri një hap të rëndësishëm drejt sigurimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi ndaj viktimave dhe vepron në mënyrë inkurajuese ndaj personave LGBTI që përjetojnë diskriminim. Një vërejtje minore për këtë rast është që Komisioni në mendimin e tyre përdori termin person “transseksual” në vend të termit “transgjinnor”.

**Në vitin 2016 vazhdon prirja e kufizimit të qasjes së personave të përkatësisë etnike rome në pishinat nëpër vendin.** Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka vendosur në bazë të parashtresës së dorëzuar nga një personi i cili deklaroi se është diskriminuar në bazë të ngjyrës së lekurës, në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime, nga ana e pishinës “Biser” në Komunën e Aerodromit, Shkup. Në parashtresën e dorëzuar, personi shpjegon se me familjen e vet ishin drejtuar kah hyrjes së pishinës “Biser” në Komunën e Aerodromit, Shkup, por nuk ia lejuan hyrjen për shkak të ngjyrës së lekurës. Ditën tjetër, dorëzuesi i parashtresës ka vendosur që prapë të tentojnë të hyjnë në pishinën, me që fillimisht kanë tentuar bashkëshortja dhe bija e tij, dhe pastaj ai me birin. Në parashtresën ai ka shënuar se bashkëshortes dhe bijes ishin lejuar të hyjnë për shkak se kishin ngjyrë më të bardhë të lekurës, ndërsa atij dhe birit nuk u lejuan të hyjnë në pishinën “Biser”. Në zyrën e biletave i kanë thënë se duhet të ketë një bilet kalimi, megjithëse të gjithë të tjerët kanë hyrë vetëm me një biletë normal. Së bashku me parashtresën, ai ka dorëzuar edhe video ku shihet se dy anëtarët e rojës nuk u lejojnë të hyjnë në pishinën. Pas nisjes së procedurës, me qëllimin e përcaktimit të saktë të gjendjes faktike, Komisioni e ka dorëzuar parashtresën deri në pishinën “Biser” në Komunën e Aerodromit, ka shikuar edhe deklaratën e pishinës “Biser”, i ka rishikuar provat e dorëzuara nga ana e dorëzuesit të parashtresës. Në mendimin e Komisioni rekomandohet që pishina “Biser” në Aerodrom ta heq lëndimin e të drejtës së dorëzuesit të parashtresës, ashtu që do ta kompensojnë dëmin e shkaktuar nga kufizimi të qasjes në shërbimet e pishinës, për shkak të ngjyrës së lekurës. Në raportin vjetor për 2016, Komisioni shënon se nuk ka qenë njoftuar nëse diskriminuesi në fjalë ka vepruar në përputhje me mendimin dhe rekomandimin e dhënë, dhe nga raporti i njëjtë nuk mund të vërehet se Komisioni ka bërë ndonjë përpjekje për të hulumtuar nëse diskriminuesi ka vepruar në përputhje me mendimin dhe rekomandimin e dhënë. As Komisioni ka shfrytëzuar mundësinë ligjore për nisje të iniciativës përpara organeve përkatëse për ta përcaktuar përgjegjësinë e kryesit.<sup>32</sup>


31 Raporti vjetor i Komitetit të Helsinkit për vitin 2016.

32 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2016.

## Veprimtaria e KMD-së në vitin 2017

Në vitin 2017 deri në Komisionin u dorëzuan 59 parashtresa, domethënë pothuajse numër të barabartë si vitin e mëparshëm. Gjatë këtij viti, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka vendosur për 84 parashtresa, dhe për 19 prej tyre ka përcaktuar se ka diskriminim dhe diskriminatorëve kanë dhënë rekomandim për heqje të diskriminimit, ndërsa në 29 raste ka vendosur se diskriminim nuk ekziston. Komisioni nuk ka marrë vendim për 31 parashtresa për shkak të moskompetencës së tyre për të verpruar në këto raste, një parashtresë është zgjidhur me marrëveshje të ndërsjelltë, ndërsa në 4 raste Komisioni ka ndërprerë procedurën.<sup>33</sup> Përsëri vërehet prirje ndryshimi të bazës së diskriminimit mbi të cilën janë dorëzuar shumica e parashtresave, ashtu që më shumë parashtresa ka për shkak të diskriminimit në bazë të seksit dhe gjinisë – 19%. Pastaj vijnë përkatësia etnike me 18%, përkatësia politike me 17%, gjendja shëndetësore me 16%, orientimi seksual dhe identiteti gjinnor me 16%, statusi personal ose shoqëror 16%, mosha 8%, prejardhja shoqërore 7% dhe arsimiti 7%. Ky ishte raporti i parë i Komisionit ku parashtresat e dorëzuara në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinnor janë ndarë si kategori të veçantë statistikore, edhe pse ato akoma nuk janë listuar në mënyrë eksplicite si baza diskriminimi në ligjin. Në shumicën e parashtresave, domethënë 32, si bazë diskriminimi është shënuar vetëm 1 bazë, ndërsa në 27 parashtresa janë shënuar disa baza diskriminimi. Në gjithsej 51 parashtresa dorëzuesit kanë shënuar nga një fushë diskriminimi, ndërsa në 8 parashtresa dorëzuesit ndiejnë se janë diskriminuar në disa fusha diskriminimi.

Tabela 14: Numri i parashtresave sipas bazave për vitin 2017




33 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2017.

Gjatë 2017, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, Komisioni ka dorëzuar një kërkesë deri në Gjykatën Themelore Shkupi 1 – Shkupi për nisje të një procedure kundërvajtëse, por kërkesa ka qenë refuzuar.

Në aspektin e fushave, nuk ka ndryshime në prirjet, këtë vitë prapë më shumë parashtrësive ka në fushën e punës dhe marrënit pune – 41%, pastaj vijnë parashtrësive në bazë të qasjes në mallra dhe shërbime – 25%, mediat dhe informimi publik – 22%, 14% në fushën e arsimit dhe 10% në fushën e sigurisë sociale, duke përfshirë këtu fushën e mbrojtjes sociale, sigurimi pensionist dhe invalid, sigurimi shëndetësor dhe mbrojtja shëndetësore.

Në aspekt të financave, domethënë përkufizimet buxhetore, përsëri theksohet se ato në përmasa të mëdha ndikojnë në masat dhe efikasitetin e zbatimit të aktiviteteve të Komisionit dhe se Qeveria nuk ka siguruar burime të përshtatshme financiare dhe njerëzore për Komisionin për ta arritur luftë efikase kundër diskriminimit. Buxheti i miratuar për këtë vit ka qenë 5.058.400,00 denarë, prej të cilave u realizuan gjithsej 4.477.915,00 denarë dhe u mbetën 219.145,00 denarë. Poashtu, në vitin 2017 gjithsej 210.120,00 denarë kanë mbetur të pashlyera.

Tabela 15: Parashtrësive të dorëzuara sipas fushave për vitin 2017



## Praktika

**Në vitin 2017 u detektuan disa njoftime punësimi me karakter diskriminues.** Domethënë, shumica e njoftimeve kërkojnë persona femër ose meshkuj për pozitë të caktuar pune ose kërkojnë që personat të jenë me moshë të caktuar, ose parashtrajnë kushte edhe për seksin edhe për moshën. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka vepruar në mënyrë efikase në bazë të këtyre parashtrësive, duke i zgjidhur me mendime pozitive brenda afatit ligjor, me rekomandime për heqje të njoftimeve

diskriminuese. Gjithsesi, edhe pse Komisioni ka lëshuar mendime të këtilla, kushtet diskriminuese punësimi akoma po shfaqen në faqen e internetit. Kjo dëshmon për nevojën për më shumë aktivitete në kuadër të parandalimit nga diskriminimi, në kuptimin e edukimit të punëdhënësve dhe ndërmjetësve gjatë procesit të punësimit, në pjesën e kushteve të lejuara punësimi të cilat nuk do të përkufizonin qasjen në punësim dhe në të ardhmen Komisioni vazhdimisht do ta theksojë rëndësinë e kësaj.

**Gjatë vitit 2017, vazhdoi prirja e diskriminimit në qasjen në mallra dhe shërbime me baza të ndryshme. Posaçërisht shqetëson fakti se në dy raste bëhet fjalë për diskriminim të personave të përkatësisë etnike rome dhe ngjyrë më të erët lekures, në dy qytete të ndryshme, ndërsa ne kemi pranuar informata edhe për rast tjetër në qytet tjetër. Njëri është në pishinë në lagjen e Aerodromit në Shkup, ndërsa tjetri në Prilep.** Në të dyja rastet, personat e diskriminuar nuk u lejuan të hyjnë në pishinë për shkak të ngjyrës së lekures, me që u kufizua qasja në mallra dhe shërbime të karakterit publik. Në rastin e parë, pas një tentimi të pasuksesshëm që të hyjë, prapë ka shkuar në pishinën me familjen e tij. Bashkëshortes dhe bijes ishin lejuar të hyjnë për shkak se kishin ngjyrë më të bardhë të lekures, ndërsa atij dhe birut nuk u lejuan të hyjnë në pishinën nga ana e personelit. Për rastet e dokumentuaram nga ana e Komitetit të Helsinkit u nisën procedura te Komisia olr mbrojtje nga diskriminimi, me që Komisioni i zgjodhi rastet me mendime pozitive dhe vendosi se ka pasur diskriminim.<sup>34</sup>

**Në fund të 2016 u mbajtën zgjedhjet e fundit parlamentare, ndërsa në vitin 2017 u mbajtën zgjedhjet e fundit lokale.** Në të dyja proceset te Komiteti i Helsinkit shpeshherë po arrinin informata nga persona me pengesa fizike se kanë probleme në realizimin e të drejtës votimi, për shkak se vendet votimi nuk kanë qasje. Nuk mungojnë as informatat nga ana e personave të verbër të cilët tregojnë se ndihen të varur dhe të pasigurt kur votojnë për shkak se votojnë me shoqërim. Përmbledhja ishte se nuk bëhet fjalë vetëm për qasjen fizike, gjë që qartësisht mungon në shumicën e vendeve votimi, por bëhet fjalë edhe për mungesë të qasje gjatë momentin e votimit për personat e verbër. Gjendja me qasjen e kufizuar në vendet votimi dhe letrat votimi të papërshtatura për personat të verbër çojnë në shkelje të të drejtës votimi dhe të fshehtësisë së votes dhe përfaqësojnë diskriminim në bazë të pengesës. U vendos se që të kemi bazë për ta ndryshuar situatën, fillimisht duhet të përcaktohet gjendja dhe trajtimi i këtyre personave gjatë procesit zgjedhor. U zgjodh metoda për provim të diskriminimit ashtuquajtur testimi i situatës me qëllim që të vërtetohet trajtimi diskriminues ndaj personave me aftësi të kufizuara në realizimin e të drejtës së tyre për votim. U zgjodh testimi për personat me karrige me rrota dhe personat e verbër. Testimi tregoi se vendet votimi janë pa qasje të posaçme për personat me karrige me rrota edhe për personat të verbër dhe për personat me të pamurit të dëmtuar të cilët nuk njohin alfabetin alfabetin Brail. E reja gjatë procesit të fundit zgjedhor ishte

34 Raporti vjetor i Komitetit të Helsinkit për vitin 2017.

udhëzimi për votim të personat të verbër dhe personat me të pamurit të dëmtuar përmes një shablloni në alfabetin Braj, i cili duhet t'i sigurojë personit të verbër ose persoit me të pamurit të dëmtuar të votojë në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë, por, në të njëjtën kohë shumica e të verbërve ose të personave me të pamurit të dëmtuar nuk e njohin alfabetin Braj. Komiteti për të dyjat raste ka nisur procedura përpara Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për ta përcaktuar diskriminim në bazë të aftësive të kufizuara në realizimin e të drejtës votimi të personave në karrige me rrota, personat e verbër dhe personat me pengesa sensore. Një fakt pozitiv është se Komisioni edhe në të dyjat raste vendosi se bëhet fjalë për diskriminim.

**Gjatë 2017 u vërejtën disa raste të gjuhës diskriminuese dhe gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor në mediat** për të cilat u nisën procedura përkatëse përpara institucionet përgjegjës. Këto përmbajtje në mediat më shesh parafiten në portalet e mediave, në televizion dhe në mediat e shtypura. Në shumicën e tyre, gjuha diskriminuese dhe gjuha e urrejtjes i përkasin definimit të homoseksualitetit si sëmundje ose perversion. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka vendosur se bëhet fjalë për diskriminim vetëm në rastin kundër një portal në gjuhën shqipe, në tri raste të tjerë nuk kanë vendosur se është diskriminim, edhe pse bëhet fjalë për përmbajtje shumë të ngjashme. Është indikative se në të gjithë këto raste, Këshilli për etikë në mediat vendosi se ka gjuhë të urrejtjes. **Rasti i parë i përket botimit elektronik dhe të shtypur të gazetës ditore “Veçer“, ku është publikuar një lajm prej një autori anonim me titull: “Faqja e internetit gay shantazon të miturit në Facebook!“ Më 23 janar 2017, lajmi është ndarë nga faqja “Kurir“, ndërsa më 17 janar 2017 është publikuar një tekst me përmbajtje të ngjashme në portalet “Infomaks“ dhe “Puls24“.** Në këtë lajm, media përdor gjuhë të urrejtjes ndaj personave me orientim homoseksual, duke i stigmatizuar njëkohësisht joheteroselsualët me deklarata që kanë për qëllim të krijojnë frikë joracionale nga këta persona te publiku dhe të nxisin dhunë verbale dhe fizike ndaj tyre. Domethënë, lajmi i kontestuar thotë se “13-vjeçarë janë target-grup i një faqeje të internetit për informim të komunitetit LGBT ‘квир.мк’ (queer.mk). Kjo faqe e internetit, e cila publikon lajme për lezbikët, homoseksualët, biseksualët, tranvestitat nëpër botë, në faqen e tyre të Facebook paguajnë reklama që lajmet e tyre t’iu paraqesin fëmijëve 13-vjeçarë“. Në vazhdim të tekstit: “Nga faqja e internetit biles nuk fshehin se qëllimi i tyre është t’iu afrohen dhe të nxisin komunikim mes personave LGBT, domethënë adoleshentë të mitur të cilët janë target grupi i tyre“. Faqja “queer.mk“ më 23 janar 2017 ka dërguar një demant, domethënë përgjigje ndaj informatën e publikuar në “Veçer“, “Kurir“, “Infomaks“, “Puls24“ и “Netpres“. Asnjë prej faqeve, përveç “Netpres“ nuk e publikoi demantin, që është kundër nenit 26 të Ligjit për mediat. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka sjell mendim se ka diskriminim dhe shqetësim në artikujt e kontestuar. Në përgjigjen e tij, Komisioni theksoi se kërkon prej gazetës ditore “Veçer“, faqet e internetit “Puls24“, “Kurir“ dhe “Infomaks“ të ofrojnë sqarim në lidhje me përmbajtjen e kontestuar. Në përgjigjen e Komisionit thuhet se sqarimi ka përmbajtur se argumentet e parashtrësës janë

plotësisht të pavërteta dhe u referuan të drejtës për lirinë e shprehjes. Fatkeqësisht, as mediat në fjalë, as Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk bëjnë dallim midis gjuhës diskriminuese dhe gjuhës së urrejtjes dhe lirisë së shprehjes.<sup>35</sup>

**Rasti tjetër i përket faqes së internetit “Infomaks“, i cili publikoi një artikull nga autor anonim me titull: “LSDM do të promovojë komunitetin LGBT në Maqedoni: Fëmijët do të mësojnë për homoseksualitetin, LGBT do të bëhet komitet i mbrojtur, dhe Ivon Veliçkovski do t’i përkrahë - të drejtat e tyre!”**

I njëjti lajm u botua të nesërmen në “Puls24” me titullin: “Fëmijët do të mësojnë për homoseksualitetin, LGBT do të bëhet komitet i mbrojtur, dhe Ivon Veliçkovski do t’i përkrahë - të drejtat e tyre!”. Në këto artikuj mediat përdorin gjuhën e urrejtjes kundër njerëzve me orientim homoseksual, duke i stigmatizuar joheteroselsualët përmes deklaratave që kanë për qëllim të krijojnë frikë iracionale nga këta njerëz te publiku dhe nxisin dhunë verbale dhe fizike ndaj tyre. Përkatësisht, titulli i lajmeve të kontestuara tregon tendencën se mediat synojnë ta zhvlerësojnë komunitetin LGBTI dhe ta portretizojnë luftën për të drejtat e barabarta dhe nevojën për të prezantuar edukimin seksual si diçka të papranueshme. Në paragrafin e parë të tekstit thuhet se “jo vetëm që do të zbatojnë Platformën e Tiranës për shqiptarizimin dhe federalizimin, LSDM planifikon të rrisë të drejtat e komunitetit LGBT përmes arritjes së më shumë të drejtave të tyre dhe përmes ngritjes së ndërgjegjësimit për tolerancën drejt homoseksualëve“. Koalicioni Margjinat ka paraqitur një ankesë te Këshilli i etikës në media dhe një parashtrësë te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi. Komisioni i ankesave pranë Këshillit të etikës në mediat vlerësoi se kishte bazë për ankesën. Sidoqoftë, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi përsëri nuk përcaktoi ekzistencën e diskriminimit ose ngacmimit. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk ka vendosur diskriminim dhe ngacmim në përputhje me Ligjin për mbrojtjen dhe parandalimin e diskriminimit. Në shpjegimin e tij të shkurtër, ky komision thjesht thotë se “Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi analizoi të gjitha faktet relevante, individualisht dhe së bashku, dhe në përputhje me Ligjin për mbrojtjen dhe parandalimin e diskriminimit ...”, pasi që përsëri nuk dalloi diskriminim, domethënë gjuhë e urrejtjes. Kjo praktikë do të vazhdojë në disa raste të tjera të diskriminimit dhe të gjuhës së urrejtjes në media.<sup>36</sup>

**Një rast tjetër ka të bëjë me programin debatues “Studio e Hapur” e TV Nova, ku u diskutua në temën “Për ose kundër martesës gay”.** Folësit në debat ishin Vlatko Gjorçev, anëtar i VMRO-DPMNE, psikologët Mirjana Jovanovska dhe Goran Gelevski dhe mjeku Georgi Stojanovski. Emisioni u moderua nga Anita Petrovska. Në këtë emision, media favorizonte qëndrime që përmbajnë gjuhë të urrejtjes ndaj homoseksualëve; homoseksualizmi u portretizua si një sëmundje dhe dukuria e padëshirueshme në një shoqëri, duke forcuar paragjykimet dhe stereotipet për

35 Raporti vjetor i Koalicionit “Margjinat” për vitin 2017.

36 Njësoj si 25.



komunitetin LGBTI. Në fjalën e tij, mjeku Georgi Stojanovski theksoi: “Diskriminimi i askujt dhe asgjë në asnjë baze. Stigmatizimi i askujt dhe asgjë në asnjë baze. Asnjë sëmundje nuk duhet paragjykuar dhe të gjitha sëmundjet duhet të trajtohen ... Mendimi im për homoseksualët bazohet në atë që kam mësuar si student 30 vjet më parë, kur kemi pasur mundësinë të studiojmë për homoseksualitetin si mjekë të ardhshëm nga psikiatri më i shquar në atë koha, dhe besoj që edhe sot në Maqedoni nuk është tejkaluar, profesori Miodrag Micev ... Në librin e psikiatrisë dhe ligjëratave të profesorit Miodrag Micev u tha në mënyrë eksplicite që homoseksualiteti është një devijim në shtytjen e seksit ose çrregullim në seksin dhe për ta bërë më të qartë për audiencën më të gjerë është një problem psikiatrik ... homoseksualiteti është, do ta përsëris, është një devijim i seksualitetit, është një çrregullim i seksit, është një gjendje patologjike në sferën e vetëdijes njerëzore. E them këtë si ekspert, si një i krishterë ... nëse dikush nisat nga teza e kundërt se nëse unë kam të drejtë si i krishterë të mbroj pikëpamjen time që homoseksualiteti është një fenomen patologjik, ai si ateist gjithashtu ka të drejtë të mbrojë pozicionin e tij .. ja një pyetje hipotetike. Nëse të gjithë burrat dhe gratë në planetin Tokë bëhen gay, ose lezbike, në çfarë mënyre do të lëvizet njerëzimi? Në drejtim të vetë-shkatërrimit, apo jo? Kjo do të thotë se nuk ka nevojë për një luftë bërthamore”.

Si rezultat, u paraqit një parashtrësë te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, një kërkesë për masë të Dhoma mjekësore, një njoftim të Ministria e Shëndetësisë, si dhe një kërkesë për një inspektim të Inspektorati shtetëror shëndetësor dhe sanitar. Komisioni i ankesave për etikën në media në mendimin e tij ka konstatuar se moderator i emisionit ka imponuar vazhdimisht një mendim sugjerues për këtë temë, i cili përmban elemente që mund të inkurajojnë diskriminimin në baza të ndryshme. Duke vepruar kështu, Komisioni konstatoi se nenet 1 dhe 10 të Kodit të gazetarëve ishin shkelur. Raporti me shkrim i Agjencisë për shërbime audio dhe audio-vizuale konfirmon shkeljen e parimeve të përmendura në nenin 61 paragrafi 1, pikat 2 dhe 9 të Ligjit për për shërbime audio dhe audio-vizuale, d.m.th. shkelje e parimeve për kryerjen e veprimtarive transmetuese në lidhje me barazinë e të drejtave të njerëzve në të gjitha bazat dhe për sa i përket parimit të paraqitjes në mënyrë objektive dhe të paanshme të ngjarjeve. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi përsëri nuk ka vendosur diskriminim.<sup>37</sup>

**Më 22 korrik 2017, në faqen e internetit Tetova Sot u botua një lajm/ artikull nga autori Savash Veliu me titull “Homoseksualizmi si degjenerim i ndyrë dhe perversë”.** Përsëri, edhe në titullin e lajmit të kontestuar, ekziston një tendencë me të cilën media synon t'i çvlerësojë homoseksualët dhe ka për qëllim të patologjizojë homoseksualitetin si “degjenerim”. “Homoseksualizmi është një devijim seksual ose një e metë fiziogjinore me çrregullim psikomental dhe iracional që është në kundërshtim me vetë natyrën. Homoseksualizmi LGBT është e dënuar nga

37 Raporti vjetor i Koalicionit “Margjinat” për vitin 2017.

profesionistët si e dëmshme për njerëzit ... Kjo çon në rritjen e problemeve të shëndetit mendor për komunitetin LGBT për shkak të stigmatizimit të tij. Deri në kohët e vona homoseksualiteti renditej tek sëmundjet mendore. Vetëm në konferencën e doktorëve të sëmundjeve mendore, të mbajtur në Amerikë në vitin 1973, u hoq homoseksualiteti nga lista e sëmundjeve nervore. Që atëherë, homoseksualët perversë, konsiderohen si njerëz normalë! Me këtë ndryshim, filluan homoseksualët të shfaqen dhe shtohen në shoqëri, pasi tashmë konsideroheshin normalë, nuk kishin frikë se mund të humbasin vendin e punës dhe nuk shiheshin me përçmim nga shoqëria siç ndodhte më parë,” thuhet në artikullin. Në këtë rast, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi gjeti ngacmim dhe nxitje të diskriminimit bazuar në orientimin seksual. Komisioni rekomandoi që portali Tetova Sot ta heq tekstin e kontestuar dhe, në të ardhmen, t'i kushtojë vëmendje vërtetësisë dhe objektivitetit, në mënyrë që të mos shqetësojë homoseksualët, duke zvogëluar kështu stereotipet dhe paragjykimet ndaj këtyre personave.

**Më 25 korrik 2017, në faqen e internetit të revistës javore “Republika” u publikoi një lajmë, e nënshkruar nga autorja Biljana Zafirova me titullin “Shkatërrohet familja, imponohet perverzion dhe nihilizëm”.** Në paragrafin e parë të lajmit thuhet: “Lufta e vlerave, disa janë ‘për’, disa janë ‘kundër’! - kjo është ajo që po ndodh me shoqërinë, kjo është ajo që po ndodh me Maqedoninë. Qeveria e drejtuar nga Zoran Zaevi ka ngritur pyetje që shumë i shohin si shkatërrim të vlerave të vërteta. E gjitha filloi me pedofilët, vazhdoi me homoseksualët, të drejtën e tyre për t'u martuar, dhe përsëri luhet me ndjenjat dhe të drejtat e fëmijëve - e drejta për të adoptuar fëmijë nga prindërit e të njëjtit seksi”. Efektet e këtij lajmi janë të dukshme edhe në faqen në Facebook të portalit “Republika”, ku është publikuar në pjesën për komente të lexuesve. Komentet përmbajnë agresion dhe poshtërim të madh ndaj komunitetit LGBTI, por edhe më keq, ka thirrje të qarta për dhunë dhe likuidim fizik bazuar në orientimin seksual. Për shkak të kësaj, Koalicioni “Margjinat” paraqiti një ankesë në Këshillin e etikës në mediat dhe një parashtrësë në Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi. Edhe në këtë rast, Komisioni i ankesave pranë Këshillit të etikës në mediat zbuloi se ka një bazë dhe prova për ankesën dhe Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk gjeti diskriminim. Komisioni i ankesave pranë Këshillit të etikës në mediat zbuloi se, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e temës dhe valën e reagimeve që ajo shkaktoi në publik, media duhej të siguronte, por nuk ka siguruar, mendimin nga të gjithë aktorët e interesuar, dhe në këtë rast edhe nga komuniteti LGBTI në mënyrë që të informojë në mënyrë objektive. Kështu, media shkelte nenin 1 të Kodit të gazetarëve.<sup>38</sup>

**Rasti më indikativ në vitin 2017 është rasti i deputetit të BDI-së Branko Manoilovski në një seancë të Komisionit për sistemin politik dhe marrëdhëniet ndërkomunitare, ku në rendin ditor ishin aktet e përgjithshme të Avokatit**

38 Njësoj si 39.



**të Popullit dhe ai shprehu mbështetjen e tij për të drejtat e njerëzve LGBTI (homoseksualët) në Republikën e Maqedonisë, përfshirë edhe të drejtën për t'u martuar.** Ligjvënësit e tjerë reagues ndaj deklaratës së tij. Deputeti i Lëvizjes BESA, Afrim Gashi, së pari doli me një deklaratë duke thënë: “Jam i bindur që në Maqedoni kemi një shoqëri konservative, ku familja është saktësisht përcaktuar se përbëhet nga një burrë dhe një grua dhe se familja ka fëmijë. Ne duhet t'i promovojmë këto vlera”. Deputeti i VMRO-DPMNE-së, Antonio Milloshoski, iu përgjigj kësaj seance me gjuhë të urrejtjes dhe tha: “Nëse disa shtete vendosin të legalizojnë fenomenet devijante në martesat e të njëjtit seks, edhe pse nuk korrespondon me vendosmërinë familjare dhe tradicionale” Pas këtij incidenti, Nënkryetari i LSDM-së dhe deputeti i parlamentit Muhamed Zeqiri postoi një mendim fetar nga Profeti Muhamed, i përdorur shpesh në kontekstin e dënimit të homoseksualizmit. Ai më vonë deklaroi për gazetën Fokus: “Unë jam teolog dhe jam kundër martesës homoseksuale dhe homoseksualizmit, ky është qëndrimi im personal”. Kjo deklaratë u pasua nga një përgjigje e organizatave të shoqërisë civile, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Qendra për mbështetje të LGBTI, Koalicioni “Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara” dhe “LGBT United” - Tetovë, të cilët i dënuan praktikat diskriminuese dhe homofobike në Parlament dhe kërkuan që deklaratat e tilla të sanksionohen. Partia VMRO-DPMNE doli me mendimin e vet për këtë incident. Përkatësisht, deputetja Blagica Llasovska bëri deklaratën e mëposhtme në njoftimin për shtyp të partisë: “Martesa është një bashkim ekskluzivisht midis një burri dhe një gruaje. Gjithmonë ka qenë kështu, është kështu duhet mbetur. Pa asnjë debat dhe pa asnjë argument, qeveria e drejtuar nga LSDM dhe BDI në mënyrë frikacake dje paraqiti një propozim për legalizimin e martesave homoseksuale, i cili mund të çojë në adoptimin fëmijëve nga çifteve të të njëjtit seks”. Për shkak të gjuhës së urrejtjes nga deputetët Milloshoski dhe Zeqiri, Koalicioni ka paraqitur parashtresa te Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi. Pas parashtresës për deputetin Milloshoski, Komisioni menjëherë vendosi se nuk ka diskriminim, dhe për deputetin Zeqiri, disa muaj më vonë, Komisioni gjithashtu nuk vendosi se ka diskriminim.<sup>39</sup>

### Veprimtaria e KMD-së në vitin 2018


Gjatë vitit 2018, te Komisioni u dorëzuan gjithsej 132 parashtresa. Është evidente se numri i parashtresave është më shumë se dy herë më i lartë sesa vitin e kaluar. Përsëri ka ndryshim në lidhje me bazat e diskriminimit, ashtu që këtë vit shumica e parashtresave ishin dorëzuar në bazë të diskriminimit të statusit personal ose shoqëror – 25%, pastaj është diskriminimi me bazë të përkatësisë politike – 21,97%, gjendja shëndetësore – 9,09%, seksi – 9,09%, përkatësia në një grup të marginalizuar – 8,33%, përkatësia etnike – 7,58%, mosha – 6,06%, pengesa trupore ose mendore – 3,79%, gjinia – 3,03%, gjendja familjare ose martësore – 3,03%, feja ose bindje fetare –

39 Njësoj si 39.

2,27% dhe orientimi seksual – 2,27%. Në 11,36% të parashtresave, dorëzuesit nuk kanë shënuar bazën e diskriminimit, ndërsa në 3,79% të parashtresave, dorëzuesit kanë shënuar se bëhet fjalë për ndonjë bazë tjetër diskriminimi. Gjatë vitit 2018, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka sjellë gjithsej 119 mendime, prej të cilave në 19 raste ka përcaktuar se ka diskriminim dhe u ka dhënë rekomandim diskriminuesve që ta heqin diskriminimin, ndërsa në 78 parashtresa Komisioni ka vendosur se nuk ka diskriminim. Në 19 parashtresa, Komisioni nuk ka nisur procedura, ndërsa në 3 raste e ka ndërprerë procedurën.<sup>40</sup>

Në shumicën e rasteve, domethënë 103 parashtresa, ka vetëm një bazë diskriminimi, në 20 raste janë shënuar dy baza diskriminimi, ndërsa në nëntë parashtresa janë përmendur tri baza diskriminimi. Në gjithsej 130 parashtresa, dorëzuesit përmendin një fushë diskriminimi, ndërsa në dy parashtresa dorëzuesit ndihen se janë diskriminuar në dy fusha diskriminimi.


Tabela 16: Numri i parashtresave sipas bazave për vitin 2018



Në aspekt të fushave, në 2018 përsëri shumica e parashtresave janë në fushën e punës dhe marrëdhënieve pune me gjithsej 49,24%, pastaj vijnë parashtresat për shkak diskriminimi në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime – 19,70%, gjyqësia dhe institucionet – 8,33%, arsimit, shkenca dhe sporti – 6,82%, siguria sociale – 3,79%, informimi publike dhe mediat – 2,27%, në fushën e strehimit – 0,76%, fusha e diskriminimit nuk është përmendur – 3,79% dhe fushë të tjera të përcaktuara me ligj – 6,82%.

40 Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi për vitin 2018.

Tabela 17: Numri i parashtresave sipas fushave për vitin 2018



Buxheti i Komisionit për këtë vit ka qenë 5.651.542,00 denarë, prej të cilave u realizuan gjithsej 5.269.474,00 denarë ndërsa 382.068,00 denarë kanë mbetur. Gjithashtu, në 2018, gjithsej 210.120,00 denarë kanë mbetur të pashlyera. Komisioni përsëri thekson se njëra prej nevojave themelore për funksionim më edikas janë resurset financiare dhe që mjetet me të cilat po disponon nuk janë të mjaftueshme për realizim të përgjegjësive të rëndësishme që janë pjesë të punës së Komisionit.

## Praktika

Në një rast të sjelljes abuzive dhe ngacmimit psikologjik nga një psikolog në Poliklinikën “Bukuresht”, autoritetet kompetente nuk gjetën shkelje të të drejtave dhe diskriminim ndaj një djali gay. Në këtë rast nga fundi i vitit 2017, një djalë homoseksual 24 vjeç, i cili iu drejtua psikologut në një institucion shëndetësor për testim psikologjikë pësoi ngacmim në bazë të orientimit të tij seksual dhe statusit pozitiv të HIV-it nga psikologu që kryente testimin. Për më tepër, për djalin ishin shkelur një seri e të drejtave të garantuara me ligj dhe ai ka pësuar diskriminim në bazë të orientimit seksual dhe gjendjes shëndetësore. Shoqata Së bashku më të fortë, në emër të djalit, paraqiti një parashtesë pranë Inspektoratit shëndetësor dhe sanitar, Avokatit të Popullit dhe Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, dhe iu drejtua edhe Odës së psikologëve të Republikës së Maqedonisë me një kërkesë për mendim ekspert. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi arriti në përfundimin se “nuk ka diskriminim, pasi parashtesa nuk ka prova që konfirmojnë besueshmërinë e bisedës me ngacmim diskriminues”. Sipas Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, barra e provës është zhvendosur te shkelësi i mundshëm, por Komisioni

me sa duket nuk e ka zbatuar këtë rregull dhe në mënyrë arbitrare ka vendosur të mos pranojë pretendimet e pacientit, edhe pse raporti me një diagnozë të dyshimtë duhet të jetë prova të mjaftueshme për të zhvendosur barrën e provës.

Në vitin 2018, Komisioni gjeti diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të fesë dhe bindjet fetare te një vajzë, të cilës iu mohua hyrja në restorantin Portofino Osteria & Bar, sepse ajo mbante një hixhab. Vendimi i Komisionit jo vetëm që përcakton diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të fesës dhe bindjes fetare, por gjithashtu detyron diskriminuesin të publikojë një falje publike në një gazetë. Një tjetër fakt pozitiv është që diskriminuesi ka vepruar sipas rekomandimit të Komisionit dhe ka lëshuar një falje publike.

Rasti më indikativ që shënoi vitin 2018 është rasti i diskriminimit të drejtpërdrejtë të vendosur kundër ish-kryeministrit Nikolla Gruevski nga Gjykata Themelore Shkup 1 dhe gjyqtarja Dobrila Kacarska. Me këtë mendim të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, i cili vendosi se ka diskriminim nga Gjykata Themelore Shkup 1 dhe gjyqtarja Dobrila Kacarska duke mosrespektuar të drejtën për gjykim të drejtë të të dënuarit me burg dyvjeçar, Nikolla Gruevski, në çështjen “Tank” vuri në dyshim besueshmërinë e mandatit të institucionit. Komisioni jo vetëm që vendosi se ka diskriminim pa e sqaruar bazën e diskriminimit (statusin personal dhe familjar) biles edhe caktoi një seancë jashtë praktikës së vendosur, por i dha përparësi parashtesës së ish-kryeministrit përpara parashtresave të tjera për të cilat kanë tejkalar afatin ligjor prej tre muajsh. Vendosja e diskriminimit në çështjen e ish-kryeministrit është vetëm një tregues i joprofesionalizmit dhe paragjykimit të Komisionit, anëtarët e të cilit me sa duket po abuzojnë me pozitën e tyre për të përcaktuar diskriminim ndaj bashkëmenduesve të tyre politikë edhe në rastet kur nuk ka diskriminim të dukshëm. Vetëm në tre vitet e fundit, anëtarët e Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi kanë parashtruar 19 ankesa në rastet e diskriminimit ndaj grupeve të marginalizuara të qytetarëve, për të cilat Komisioni ka vonesë mesatarisht katër muaj dhe për tre nga ankesat e paraqitura ka më shumë se një vit vonesë. Për shembull, Komisioni nuk ka vendosur ende për ankesën kundër Millenko Nedellkovski, dërguar më 2 shkurt 2017. Përkundër këtij qëndrimi të injorimit të komuniteteve të marginalizuara, Komisioni ka vepruar shpejt dhe brenda afatit ligjor në rastin e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski. Duke pasur parasysh gjithë kontekstin politik, vëmendjen e mediave në këtë rast, si dhe “efikasitetin” e Komisionit në trajtimin e këtij rasti, është për t’u habitur se si ky rast nuk u gjet në raportin vjetor të fundit të Komisionit, si një nga rasteve të zgjidhura më shpejt nga themelimi i Komisionit.

## VI. Gjetjet nga intervistat me anëtarët e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi

### Qëndrimet për përhapjen e diskriminimit dhe parashtrirat e dorëzuara

Anëtarët e mëparshëm dhe aktualë të Komisionit kanë qendrimet e ndryshme për përfaqësimin e disa bazave të diskriminimit në shoqërinë tonë. Përkatësisht, dy anëtarë të Komisionit deklaruan pikëpamje identike, përkatësisht se diskriminimi është më i zakonshëm në vendin tonë në bazë të përkatësisë etnike dhe përkatësisë politike dhe, sipas tyre, parashtrirat pasqyrojnë situatën aktuale dhe ekzistencën e diskriminimit në shoqërinë tonë. Përkundër këtyre pikëpamjeve, një anëtar tjetër i Komisionit konsideron se në shoqërinë tonë ka diskriminimin më të bazuar në statusin shoqëror (njerëzit e varfër), diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar të çdo lloji dhe diskriminimin në bazë të etnisë, mbi të gjitha, ndaj romëve. Sipas këtij anëtari të Komisionit, këto kategori personash janë më të shumtët dhe më të diskriminuarit në shoqërinë tonë, dhe vërtetimi që ata janë të diskriminuar është më të vështirë. Gjithashtu, shqetësues është fakti që të varfërit, përkatësisht personat me status të ulët shoqëror, nuk përfaqësohen sa duhet nga shoqatat e qytetarëve, siç është rasti me romët dhe personat me aftësi të kufizuara të përfaqësuara nga një numër organizatash. Përkundër kësaj mbizotërimi të lartë të diskriminimit në bazë të statusit shoqëror, aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë etnike, te romët nuk pasqyrohet fare në parashtrirat e dorëzuara për diskriminim, jo vetëm në mandatin e mëparshëm, por edhe në mandatin aktual të Komisionit.

Nga ana tjetër, njëri prej anëtarëve të Komisionit konsideron se ka gjithnjë e më shumë arsye për diskriminim në shoqërinë tonë për shkak të seksit, paaftësisë, moshës, përkatësisë politike, orientimit seksual, etnisë, etj. Vetëm një anëtar i Komisionit deklaroi se diskriminimi për shkak të seksit ose shtatzënisë është më i përhapuri dhe se ai nuk është i përfaqësuar sa duhet në parashtrirat.

Shumica e anëtarëve të intervistuar të Komisionit konsiderojnë se parashtrirat e paraqitura edhe sipas bazës edhe sipas vëllimit nuk janë një tregues dhe pasqyrim i ekzistencës së situatave reale që lidhen me fenomenin e diskriminimit.

Njëri nga anëtarët e Komisionit vuri në dukje se rritja e ankesave në bazë të përkatësisë politike ndodhi në të dy mandatet e KMD-së, si rezultat të ndryshimeve të kryetarëve të komunave, por provimi i diskriminimit në këtë bazë është jashtëzakonisht i vështirë dhe në të njëjtën kohë ekziston mundësia e ndikimit politik.

Lidhur me parashtrirat faktike, anëtarët e intervistuar të Komisionit deklaruan se parashtrirat e paraqitura gjatë mandatit të tyre ishin të bazave të ndryshme: përkatësia etnike, përkatësia politike, paaftësia ose hendikepi, orientimi seksual, statusi shoqëror, gjendja shëndetësore, moshja dhe përkatësia fetare.

Për të konstatuar qëndrimin dhe perceptimin e anëtarëve të Komisionit nëse ka pasur ndonjë ndryshim në llojin dhe fushën e ankesave të paraqitura në mënyrë retrospektive, i pyetëm nëse kishte ndonjë ndryshim dhe cilat ishin ato. Secili prej anëtarëve të Komisionit ka parashtruar aspekte të ndryshme për të cilat mendon se janë përmirësuar ose avancuar në vitet e fundit. Kështu që, sipas disa anëtarëve të Komisionit, zvogëlohet numri i ankesave që refuzohen për shkak të mungesës së juridiksionit, gjegjësisht edhe për arsyen e mungesës së indikacioneve se bëhet fjalë për diskriminim. Prandaj, mund të konkludojmë se ndryshimi më i madh i dukshëm është në njohjen e duhur të diskriminimit nga qytetarët kundrejt abuzimeve të tjera të të drejtave të njeriut. Sipas disa prej anëtarëve të Komisionit, një tjetër ndryshim është numri i rritur të parashtrirave. Një prej anëtarëve të Komisionit konsideron se parashtrirat për orientimin seksual janë më të shpeshta kohët e fundit. Asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk tregoi se ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në arsyet e diskriminimit ndër vite.

Shumica e anëtarëve të intervistuar të Komisionit konsiderojnë se parashtrirat e paraqitura në të dyja arsyet dhe vëllimin nuk janë një tregues dhe pasqyrim i ekzistencës së situatave reale të lidhura me fenomenin e diskriminimit dhe praktikave diskriminuese në vendin tonë.

### Ingjerenat e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi

#### Prioritetizimi i ingjerecave të Komisionit

Të gjithë anëtarët e Komisionit shprehën pikëpamje identike se cilat janë kompetencat prioritare të Komisionit. Përkatësisht, puna e menjëhershme mbi parashtrirat dhe veprimi efikas është kompetenca më e rëndësishme e Komisionit. Prioriteti i dytë është kompetenca e KMD-së për parandalimin dhe edukimin, pra ngritjen e vetëdijes publike, promovimin e punës së Komisionit dhe edukimin e publikut për çështje që lidhen me diskriminimin dhe mbrojtjen e tyre. Në këtë mënyrë, nëse njerëzit

njihen më tepër, ata do të kërkojnë ndihmë për të ushtruar të drejtat e tyre. Sipas disa anëtarëve, publiku nuk është informuar fare për ekzistencën e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, siç është rasti me Avokatin e Popullit.

Njëri nga anëtarët e Komisionit beson se aktivitete të tilla do të forcojnë besimin e qytetarëve në këtë institucion të pavarur për barazi, i cili në masë të madhe është i ndërprerë.

Gjithashtu u theksua që pikërisht këto kompetenca që janë me përparësi kryesore kërkojnë më pak fonde financiare, natyrisht, nëse ka një komision profesional dhe ekspert për mbrojtje nga diskriminimi.

Sipas njërit prej anëtarëve, kompetenca e Komisionit për të monitoruar situatën dhe tendencat në lidhje me diskriminimin është jashtëzakonisht e rëndësishme, por mund të realizohet vetëm nëse kemi KMD-në në kuptimin e vërtetë të fjalës me një strukturë të ndërtuar, pra me ekzistencën e sektorëve ose departamentet e caktuar, si dhe një organ ekspert-administrativ.

Gjysma e anëtarëve konsiderojnë se Komisioni ka kompetenca të mjaftueshme të përcaktuara me ligj, në përputhje me zgjidhjen ligjore ekzistuese.

Dy prej anëtarëve të Komisionit konsiderojnë se KMD ka shumë kompetenca dhe ato nuk korrespondojnë me kapacitetin aktual të KMD-së dhe mundësive ekzistuese financiare. Përkatësisht, është praktikisht e pamundur me një kapacitet të tillë dhe pa një organ të specializuar administrativ që do të ndihmonte në realizimin e kompetencave të tilla, që secili nga shtatë anëtarët e Komisionit të vendosë për parashtrës, të zhvillojë fushata publike, të kryejë edukimin e popullatës, të mbledhë të dhënat statistikore, të përgatisë analiza dhe ta monitorojë situatën, etj. E gjithë kjo ka kontribuar në faktin se shumë nga kompetencat ligjore si në përbërjen e mëparshme ashtu edhe në atë aktual të Komisionit nuk janë zbatuar.

### **Kohëzgjatja e procedurave për diskriminim**

Përfaqësuesit e intervistuar të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi treguan periudha të ndryshme kohore gjatë së cilës ata vepruan sipas parashtrës dhe vendosën diskriminim.

Anëtarët e përbërjes së parë të Komisionit treguan që afati tremujor shpesh ishte tejkaluar dhe se procedurat e diskriminimit zgjatën deri në gjashtë muaj, në varësi të llojit të parashtrës. Përkatësisht, vendimmarrja mesatare varion nga tre, katër dhe pesë muaj. Një anëtar i cili ka shërbyer në të dy mandatet e KMD-së beson se afati 90-ditor është shpesh i pamjaftueshëm për t'i mundësuar Komisionit të veprojë dhe të përfundojë procedurën e diskriminimit. Në pjesën më të madhe, arsytet e tejkalimit

të afateve sipas anëtarëve të Komisionit nga përbërja e mëparshme janë për faktin se nuk ka shërbim profesional-administrativ, e jo për shkak të vëllimit të parashtrës. Në të njëjtën kohë, si arsye të tjera i përmendin problemet me ofrimin dhe mungesën e shërbimit poste që do të mundësonte shpërndarjen e shpejtë dhe të rregullt. Anëtarët e Komisionit gjithashtu theksuan se si Komision, ata gjithmonë kishin marrë parasysh interesin e personit që bën ankesën, d.m.th që ishte diskriminuar, kështu që nëse ky person nuk kishte prova të përshtatshme, që në fakt nuk është detyrë e tij, anëtarët e Komisionit, në interes të personit, mblodhën prova shtesë nga personi i diskriminuar.

Për dallim nga anëtarët e përbërjes së parë të Komisionit, anëtarët e përbërjes së dytë të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi thonë se vetëm në raste të jashtëzakonshme Komisioni e tejkalon afatin ligjor prej 90 ditësh, pra në 10% të parashtrës. Arsytet që u përmendën si faktorë për vonimin e procedurave janë: pengimi i komunikimit me një diskriminues të mundshëm (autoriteti shtetëror ose entiteti privat), në kuptimin që ata nuk përgjigjen brenda afatit të përcaktuar me ligj, dhe shpesh dërgojnë lidhje personale për të paraqitur dokumentacionin e kërkuar. Shumë shpesh ndodh që një përgjigje e tillë e vonuar të mos përmbajë faktet dhe provat e kërkuara, por përkundrazi një përgjigje që është jo e kënaqshme dhe më diplomatike. Kjo është për më tepër, nëse bëhet fjalë për një parashtrës për diskriminim nga institucione të shumta, e cila gjithashtu kërkon kohë për të vendosur komunikim me të gjitha institucionet, për ata të ofrojnë deklaratën e tyre dhe për të siguruar faktet dhe provat e nevojshme.

### **Informimi i publikut për rastet e diskriminimit, si dhe ndërmarrje e aktiviteteve për informim, promovim dhe edukim për barazinë, të drejtat e njeriut dhe jodiskriminim.**

Të gjithë anëtarët e intervistuar të Komisionit dhanë përgjigje afërsisht identike, dhe ato kryesisht i referohen mundësive reale që ata kanë pasur si anëtarë dhe si Komision për të ndërmarrë aktivitete të tilla. Përkatësisht, gjatë ndërmarrjes së këtyre llojeve të veprimtarive, u theksua roli kryesor i Komisionit të OSBE-së në Shkup, i cili vazhdimisht ka ndihmuar dhe forcuar punën e Komisionit financiarisht dhe teknikisht që nga themelimi i tij. Në të njëjtën kohë, të gjithë anëtarët e Komisionit njohin rolin e OSBE-së në promovimin e punës së Komisionit në nivelin lokal përmes zbatimit të një sërë aktiviteteve të kryera në më shumë se 30 bashki, 60 zyra rajonale të Qendrave për Punë Sociale dhe Punësim. Mbështetja e OSBE-së gjithashtu ishte e theksuar në drejtim të sigurimit të fondeve dhe asistencës teknike në përgatitjen e analizave dhe hulumtimeve tematike mbi diskriminim.

Mungesa e mjeteve financiare u identifikua nga të gjithë anëtarët e Komisionit si arsyeja kryesore pse ata nuk ishin në gjendje të nisnin në mënyrë të pavarur dhe të kryejnë aktivitete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjen e diskriminimit, as ngjarje edukative mbi barazinë, të drejtat e njeriut dhe



mosdiskriminimin. Duke pasur parasysh këtë, e vetmja mënyrë me të cilën anëtarët e Komisionit treguan përfshirjen e tyre të drejtpërdrejtë në ngjarje edukative, tryeza të rrumbullakëta për të promovuar barazinë dhe mosdiskriminimin, si dhe mandati i Komisionit ishin aktivitetet e organizuara nga disa shoqata qytetare si pjesë të disa projekteve.

Fatkeqësisht, u vërejt se shteti nuk ndan as fonde minimale me qëllim të informimit të publikut për çështjen e diskriminimit.

Aktiviteti i vetëm që anëtarët e Komisionit e konsiderojnë thelbësor është përgatitja e rregullt e raporteve vjetore për punën e Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e tyre te publiku më i gjerë të përgjithshëm dhe ekspert, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Në mandatin aktual, një hap pozitiv ka qenë sigurimi i fondeve minimale për punësimin e një personi të pavarur për të promovuar punën e KMD-së përmes një profili në Facebook, i cili ka rritur numrin e parashtrësive. Fatkeqësisht, kjo faqe në Facebook nuk po funksionon tani. Ana negative është gjithashtu mungesa e mjeteve financiare për mirëmbajtjen e faqes së internetit të Komisionit, e cila është një mangësi serioze në promovimin e punës transparente, të përgjegjshme dhe efikase të KMD-së.

### **Grumbullimi i të dhënave statistikore, formimi i bazës së të dhënave, zbairimi i studimeve dhe hulumtimeve**

Disa anëtarë të Komisionit konsiderojnë se nuk ka sistem të vetëm dhe të centralizuar për mbledhjen, regjistrimin dhe analizimin e të dhënave të diskriminimit, i cili do të sigurojë mundësinë e monitorimit të vazhdueshëm dhe analizës së diskriminimit. Në të njëjtën kohë, u deklarua se nuk ka protokolle të standardizuara për mbledhjen e të dhënave, as mekanizëm për qarkullimin e tyre dhe mbledhjen në një vend. Të dhënat nuk mblidhen në mënyrë të vazhdueshme, por përkundrazi, “ad hoc sipas nevojës”, në mënyrë që ato të mund të përdoren për përgatitjen e analizave ose hulumtimeve specifike. Prandaj, nuk ka mundësi për të ndjekur tendenca të caktuara në lidhje me shfaqjen, përhapjen e formave të diskriminimit dhe fushat në të cilat është më e përhapur, dhe kështu të ketë veprime më të hollësishme dhe të përqendruara për të parandaluar dhe mbrojtur kundër diskriminimit.

Gjithashtu u theksua që Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi mban një bazë të dhënash të brendshme që përfshin parametrat e mëposhtëm: numrin dhe llojin e parashtrësive në vit, bazat diskriminuese dhe fushat, ndërsa personat e jashtëm të angazhuar që të ndihmojnë Komisionin janë staf administrativ - teknik dhe deri diku ata mirëmbajnë këtë bazë të dhënash.

Përgatitja e analizave dhe hulumtimeve është praktikisht e pamundur për KMD duke pasur parasysh faktin se nuk ka fonde shtetërore për këtë qëllim. Përkatesisht, analizat dhe hulumtimet e përgatitura nga KMD u mbështetën financiarisht nga Misioni i OSBE-së dhe duke përdorur ekspertizën e anëtarëve individualë të Komisionit për të analizuar çështje të caktuara tematike në lidhje me diskriminimin, siç janë: Raporti i studimit për diskriminimin në punësim, Hulumtimi mbi përshtatjen e duhur në vendin e punës për personat me aftësi të kufizuara; Stereotipet, paragjykimet dhe diskriminimi në arsim: Përqendrim mbi librat shkollorë në arsimin fillor; Analiza e harmonizimit të legjislacionit vendas për barazinë dhe mosdiskriminimin; Hulumtimi mbi hendekun gjinor të pagave në nivel kombëtar etj.

### **Dukshmëria e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi në publik**

Dukshmëria e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi është një mangësi kryesore e identifikuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, si nga mandati i mëparshëm ashtu edhe nga ai aktual. Secili anëtar i Komisionit siguroi kualifikime të ndryshme dhe specifike për dukshmërinë e KMD-së, si dhe për faktorët që kontribuojnë në dukshmëri. Pra, sipas njërit prej anëtarëve, KMD-ja sot është më pak e dukshme se ka qenë në periudhën 2011-2016. Për më tepër, dy anëtarë të Komisionit me mandate të ndryshme në KMD konsiderojnë se Komisioni aktual është i dukshëm vetëm përmes pikëpamjeve politike dhe veprimeve të anëtarëve të caktuar, dhe kështu për fat të keq e konsiderojnë dukshmërinë e tij të jetë më e madhe, por në një kuptim negativ, “Pikëpamjet politike dhe veprimet e disa anëtarëve të KMD, për fat të keq, kontribuan në imazhin negativ”.

Në mënyrë të ngjajshme, një nga anëtarët e Komisionit beson se KMD-ja dhe anëtarët e tij të mëparshëm dhe aktualë kanë krijuar një imazh negativ te publiku dhe se publiku i percepton anëtarët e Komisionit si joprofesional, të pakualifikuar, të paditur dhe partiak. Anëtari i Komisionit konsideron se, për fat të keq, edhe më parë edhe tani kishin anëtarë jashtëzakonisht profesionalë dhe tejet joprofesionalë, të cilët kanë minuar integritetin e këtij institucioni. Pikëpamjet e këtij anëtari janë që Komisioni dhe anëtarët e tij nuk janë mjaft proaktivë kur bëhet fjalë për dukshmërinë e jashtme, pra në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Ky perceptim është gjithashtu karakteristik për një anëtar tjetër, i cili theksoi se Komisioni është me dukshmëri dhe përfaqësim tejet i ulët dhe se deri më tani nuk i është përgjigjur praktikave të caktuara diskriminuese të zbuluara përmes mediave në publik.

Vetëm një nga anëtarët e Komisionit dha një vlerësim pozitiv të dukshmërisë aktuale të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, d.m.th që është më i dukshëm sot sesa në tre vitet e kaluara, si rezultat i rritjes së angazhimit, kujtesës institucionale dhe përvojës së përbërjes aktuale të Komisionit.

## Problemet me të cilët janë ballafaquar anëtarët e Komisionit gjatë mandatit të tyre

Përgjithësisht, ekziston pajtueshmëri rreth problemeve të identifikuara me të cilat janë ballafaquar anëtarët e Komisionit (ish/të tanishëm) gjatë mandatit të tyre. Gjithashtu, kanë qëndrime përafërsisht identike se problemet thelbësore që ekzistojnë që nga 2011 deri tani, fatkeqësisht, tashmë nuk janë tejkaluar.

Njëri prej problemeve thelbësore me të cilat po ballafaqohet Komisioni është mungesa e mjeteve financiare dhe hapësirë të përshtatshme për realizim të plotë të kompetencave të tyre, si dhe mosekzistimi i mjeteve për formim të një shërbimi ose një sekretariati për punët profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit. Në mungesë të një shërbimi të këtillë, në përputhje me zgjidhjen e tanishme ligjore, punët profesional-administrative dhe teknike i kanë zbatuar Komisioni, me ndihmë të tre personave nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Po ahstu, u përmendën edhe probleme të tjera me të cilët anëtarët e Komisionit janë ballafaquar gjatë mandatit të tyre: mosekzistimi i lokacionit të përshtatshëm dhe aksesin fizik posaçërisht për personat me pengesa fizike, mosekzistimi i një stafi të përshtatshëm për menaxhim dhe përditësim të faqes së internetit të KMD-së, mosekzistimit të një shërbimi efikas për postë etj.

## Përfitimet prej Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Në lidhje me pyetjen se çfarë konsiderojnë anëtarët e Komisionit se faktikisht mund të përmirësohet me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi mund të konstatohen dy qëndrime plotësisht të ndryshëm. Domethënë, gjysma e anëtarëve të Komisionit nuk presin se ligji i ri do të sjellë ndryshime thelbësore në qoftë se ato nuk janë shoqëruar nga alokime të përstatshme financiare nga shteti që të mund t'i realizojnë në mënyrë të suksesshme të gjitha kompetencat, që tani me ligjin e ri janë edhe më të zgjeruara. Pikëpamja e tillë është përkrahur edhe nga qëndrimi i një anëtari të Komisionit se Komisioni biles edhe deri tani ka vepruar në mënyrë efikase edhe me kohë dhe anëtarët deri tani kanë qenë profesionalë, me arsim dhe ekspertizë të përshtatshme në fushë. Sipas anëtarëve të Komisionit, pengesa e vetme në realizimin e kompetencave të Komisionit ka qenë mosekzistimi i një organi profesional dhe mosekzistimi i vullnetit nga ana e shtetit që të ofrojë mjete serioze financiare për realizim të të gjitha kompetencave. Ekziston mendim te njëri i anëtarëve të Komisionit se nuk ka nevojë të angazhohen persona – anëtarë me kohë të plotë pune për shkak që orari i tyre pune nuk shfrytëzohet plotësisht. Njëkohësisht, kjo kjo lidhet edhe me qëndrimin se struktura e këtilla shumë të ngarkuar të Komisionit të ri do të thotë më shumë shpenzime shtetërore për një organ për barazi dhe jodiskriminim, që në fakt mund të shtohet te kompetencat e Avokatit të Popullit.

Pjesa tjetër e anëtarëve të Komisionit konsiderojnë se me miratimin e Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, para se të gjithash, do të kontribuohet për profesionalizmin e anëtarëve, përkatësisht do të ketë anëtarë të Komisionit që, para se të gjithash do të jenë persona jopartiakë me përvojë pune shumëvjeçare në fushën përkatëse, dhe se do të jenë të punësuar me kohë të plotë. Në këtë mënyrë do të siguronte ekzistimi i një komisioni efikas, profesional dhe të pavarur. Si një zgjidje pozitive konsiderohet shkurtimi i afatit kohor në 60 ditë për veprime nga ana e Komisionit, me që do të kontribuonte për mbrojtje efikase nga diskriminimi. Gjithsesi, këta anëtarë besojnë se efikasiteti do të përmirësohet me formimin e shërbimit të ri administrativ pranë Komisionit.

Asnjë prej anëtarëve të Komisionit nuk e ka thënë rëndësinë e mundësisë për shfrytëzim të padive për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik (action popularis) për të cilat ligji nuk kërkon që të ekzistojë ndonjë viktimë individuale, por si provë përdoren të dhënat statistikore ose testim të situatave të ndryshme, ndërsa personat të cilët do të nisin procedura për mbrojtje nga diskriminimi do të çlirohen nga shpenzimet për taksat gjyqësore.

## Masat specifike për përmirësim të gjendjeve në lidhje me diskriminimin

Secili prej anëtarëve të Komisionit sugjeroi që të ndërmerren masa specifike për përmirësim të gjendjeve në lidhje me diskriminimin.

Njëri prej anëtarëve të Komisionit konsideron se është e nevojshme që komisioni i ri të sigurojë raport përafërsisht real të parashtrësive të dorëzuara dhe bazave reale të diskriminimit në shoqërinë tonë. Njëkohësisht, është e nevojshme që organizatat joqeveritare, përmes përkrahjes financiare, t'i përforcojnë kapacitetet e shoqatave të qytetarëve të cilët punojnë me persona me aftësi të kufizuara.

Duke pasur parasysh faktin se personat e varfër, personat me pengesa dhe romët janë më të diskriminuar në shoqërinë tonë, një anëtar tjetër i Komisionit konsideron se duhet dhënë përparësi këtyre kategorive. Gjegjësisht, në lidhje me personat që janë në margjinat e ekzistencës sociale duhet ndërmarrë aksion për ngritje dhe përforsim të ndërgjegjës me qëllim që ata të inkurajohen dhe të mos kenë frikë që të dorëzojnë parashtrësia. Përkatësisht, sipas një anëtari të Komisionit, shumë prej këtyre njerëzve kanë frikë nga pasoja nëse raportojnë diskriminimin. Në të njëjtën kohë, është gjithashtu e nevojshme që këtyre personave t'u ofrohet ndihmë juridike falas në paraqitjen e parashtrësive. Nga ana tjetër, në lidhje me personat me aftësi të kufizuara duhet të demonopolizohet modeli i aleancave me personave me pengesa të caktuara dhe t'i favorizojnë ata duke marrë fonde shtetërore, gjë që i vë organizatat e tjera për persona me aftësi të kufizuara në disavantazh. Organizatat që janë të krijuara në këtë mënyrë nuk kanë asnjë interes për të mbrojtur dhe përfaqësuar të drejtat individuale

të personave me aftësi të kufizuara përmes përdorimit të fondeve buxhetore. Sa i përket diskriminimit ndaj romëve, shteti duhet të ndërmarrë reforma sistemike dhe masa për integrimin e tyre në të gjitha sferat e shoqërisë.

Një anëtar tjetër konsideron se është e nevojshme të decentralizohen kompetencat e KMD-së në nivelin rajonal pas shembullit të Avokatit të Popullit.

Sipas një anëtari tjetër të Komisionit, duhet nisur ndryshime në Kodin e Punës për të parandaluar praktikën negative të pushimit të grave shtatzëna pas skadimit të kontratës së përkohshme pune. Në lidhje me personat që përdorin karrige me rrota duhet pajisur me rampa. Megjithëse kishte një vendim të Qeverisë për të zbatuar këtë masë, për fat të keq nuk ka vendosur rampa të tilla aksesit.

Nga ana tjetër, njëri nga anëtarët e Komisionit konsideron se një nga disavantazhet kryesore kur bëhet fjalë për suksesin thelbësor të organeve kundër diskriminimit është që KMD, ashtu si Avokati i Popullit, miraton mendime që kanë vetëm një rol këshillues dhe parandalues, e jo ligjërishit detyruës. Anëtari i komisionit përmendi punën e Mbrojtësit të Popullit në Republikën e Serbisë si një shembull i mirë, ku ligji parashikon që nëse diskriminuesi nuk e zbaton rekomandimin ose nuk e njofton Mbrojtësit të Popullit që ai ka vepruar, Mbrojtësi merr një vendim ku e paralajmëron dhe e detyron me një afat të ri 30-ditor për të korrigjuar shkeljen. Zgjidhja është përfundimtare dhe asnjë kundërshtim nuk lejohet kundër tij. Nëse diskriminuesi nuk vepron brenda 30 ditëve shtesë, Mbrojtësi është i detyruar të informojë publikun duke shpallur publikisht që një person i caktuar ka kryer diskriminim, mënyrën në të cilën ai ose ajo ka kryer rekomandimin që i është dhënë atij ose asaj, dhe nuk ka vepruar sipas rekomandimit. Në këtë mënyrë, publiku informohet edhe për diskriminuesit dhe veprimet e tyre. Për më tepër, anëtari i Komisionit konsideron se zgjidhja e re ligjore duhet të sigurojë një procedurë pajtimi, ndërmjetësimi. Ndërmjetësimi është një nga metodat e zgjidhjes paqësore të problemit, veçanërisht në marrëdhëniet e punës, ku diskriminimi është më i përhapur. Nëse palët bien dakord, marrëveshja e arritur bëhet e zbatueshme dhe efektive. Në të njëjtën kohë, anëtari konsideron se ka nevojë për të siguruar një sistem të autonomisë financiare të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në mënyrë që të zvogëlojë rreziqet e çdo lloj ndikimi në punën e tij.

Të gjithë gjashtë anëtarët e Komisionit kanë qendrim identike mbi nevojën për të ndërmarrë veprime për të rritur ndërgjegjësimin e publikut midis qytetarëve dhe të gjithë personave të tjerë për mbrojtjen e së drejtës për barazi dhe mundësitë e përdorimit të mekanizmave të mbrojtjes nga diskriminimi, përmes financimit të fushatave, mbështetje për projekte dhe shoqata të qytetarëve, sindikatat dhe format e tjera që punojnë në fushën e mbrojtjes dhe parandalimit të diskriminimit.

## VII. Konkluzionet

1. Në shumicën e rasteve, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk vepron brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj. Në disa raste, afati për të dhënë një opinion tejkalohet edhe për disa muaj.
2. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk ka mbështetje administrativo-teknike, përkatësisht një sekretariat.
3. Një pjesë shumë e vogël e buxhetit të shtetit i kushtohet punës së Komisionit, i cili është i mjaftueshëm vetëm për të mbuluar pagat dhe shtesat e anëtarëve të Komisionit dhe shpenzimet komunale të këtij organi.
4. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk ka një bazë të dhënash të unifikuar dhe elektronike.
5. Në 2017 dhe 2018, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi nuk kishte një faqe të internetit funksionuese.
6. Shembujt praktikë të paraqitur në analizë tregojnë mospërputhje, joprofesionizëm dhe tendencë në veprimin e Komisionit kundër diskriminimit. Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi vepron ndryshe në raste të njëjta ose të ngjashme në varësi të përkatësisë politike të diskriminuesit të mundshëm.
7. Disa nga anëtarët e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi nuk kanë përvojë të mëparshme në terren dhe punojnë me grupe të cenueshme. Disa anëtarë të Komisionit gjatë mandatit të tyre ishin të lidhur me koalicionin e Qeverisë së atëhershme dhe kishin një histori diskriminimi dhe të gjuhës së urrejtjes.
8. Komisionit i mungon një dënim publik i diskriminimit në media kundër grupeve të marginalizuara, në mënyrë që të ushtrojë një rol parandalues nën LPMD.
9. Komisioni nuk merr masa për të siguruar se mediat që vazhdimisht transmetojnë përmbajtje homofobike do të sanksionohen.
10. Komisioni nuk ka filluar asnjë procedurë zyrtare nën LPMD.

11. Komisioni vetëm një herë ka ngritur procedurë kundërvajtëse kundër një diskriminuesi i cili nuk ka zbatuar rekomandimet e Komisionit për të eliminuar diskriminimin.
12. Komisioni nuk e shfrytëzon mundësinë ligjore për t'u bërë bashkëbisedues dhe/ose iniciator i padive për mbrojtje nga diskriminimi në rastet e diskriminimit ndaj një grupi më të madh njerëzish.

## VIII. Bibliografia

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, faqja e internetit të Kuvendit të RMV,

<http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/Kushtetuta%20e%20RM-se%20Final%20ALB.pdf>

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi,

"Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 50/10, 44/14, 150/15, 31/16 dhe 21/18.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi,

"Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 101/2019.

Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave (teksti i pastruar),

"Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 201/2015 viti (6/12, 166/14, 150/15). Ligji për mundësi të barabarta midis grave dhe burrave, "Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 66/2006.

Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës,

"Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 79/2013, 147/2015.

Ligji për marrëdhëniet pune (teksti i pastruar),

"Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 167/2015.

Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (teksti i konsoliduar), faqja e internetit të MPPS,

<http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2018/198%202018%20ZAKON%20ZA%20ZASTITA%20NA%20DECATA%20%20D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D0%B4%D0%B8%D1%80%D0%B0%D0%BD%20%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82-converted.pdf>

Ligji për mbrojtje sociale,

"Gazeta zyrtare e RMV", nr. 104/2019.

Kodi Penal (teksti i pastruar),

"Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17, 170/17 dhe 248/18.

Ligji për gjykatat (teksti i pastruar),

"Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 61/2008, 118/2008, 16/2009, 150/2010, 39/2012, 83/2018, 198/2018 dhe 96/2019.



Ligji për prokurorinë publike (teksti i pastruar),

“Gazeta zyrtare e RMV-së”, nr. 150/2007, 111/2008, 16/2009 dhe 198/2018.

Strategjia kombëtare për barazi dhe jodiskriminim (2016-2020), faqja e internetit të MPPS:

[http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/7.7\\_Strategjia%20za%20ednakvost%20i%20nediskriminacija.pdf](http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/7.7_Strategjia%20za%20ednakvost%20i%20nediskriminacija.pdf).

Raporti mbi progresin e RMV-së për vitin 2018,

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2011,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi.

Raporti i rregullt i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2012,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2013.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2013,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, prill 2014.

Raporti i rregullt i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2014,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2015.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2015,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2016.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2016,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2017.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2017,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2018.

Raporti vjetor i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2018,

Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2019.

Raporti i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi,

Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2014.

Raporti vjetor i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi për vitin 2014,

Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, mars 2015.

Raporti në hije për Komisionin për mbrojtje nga diskriminimi,

Raporti mbi punën e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi gjatë vitit të parë të ekzistimit të tij, dr. Mirjana Najçevska dhe m-r Luan Imeri; Fondacioni Shoqëria e hapur – Maqedonia, mars 2012.

Raporti vjetor për gjendjet në fushën e të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë për vitin 2015,

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, prill 2016.

Raporti vjetor për gjendjet në fushën e të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016,

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, qershor 2017.

Raporti vjetor për vitin 2017 të Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë,

Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, maj 2018.

Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara: raporti vjetor 2017, Dragana Dërndarevska, Irena Cvetkoviq, Andrej Senih, Vllatko Dekov, Natasha Boshkova;

Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” SHKUP – MARGJINAT.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.724:340.13(497.7)(047.31)

35.075.2:342.724(497.7)"2011/19"(047.31)

ЈАДРОВСКИ, Игор

Извештај за имплементација на Законот за спречување и заштита од дискриминација / [автори Игор Јадровски, Јована Јовановска, Марија Гелевска]. - Скопје : Коалиција Сексуални и здравствени права на маргинализираните заедници, 2019. - 87 стр. :

илустр. ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 83-85

ISBN 978-608-4803-12-6

1. Јовановска, Јована [автор] 2. Гелевска, Марија [автор]

а) Комисија за заштита од дискриминација - Активности - Македонија - 2011-2019 - Извештаи б) Спречување и заштита од дискриминација - Правна регулатива - Македонија - Извештаи

COBISS.MK-ID 110630154

